



Prirjet e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare

**Një monitorim i disa mediave të
shkruara dhe online**

Ky monitorim u mundësua nga Fondacioni
Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Hyrje

Edhe pse në përgjithësi mediat në Shqipëri nuk kanë treguar probleme madhore në lidhje me gjuhën e urrejtjes, në një shoqëri që po përpiqet të hapet gjithnjë e më shumë ndaj grupeve më të marginalizuara rreziku për të kaluar kufirin e gjuhës korrekte bëhet gjithnjë e më i fortë. Ndërkohë që organizatat përkatëse të të drejtave të njeriut janë të ndjeshme ndaj pasqyrimin mediatik, nuk ekzistojnë monitorime sistematike dhe të vazhdueshme të medias në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

Gjithashtu, ndërkohë që mediat vetë mund të jenë korrekte në raportim, platformat e reja interaktive, si për mediat e reja, ashtu dhe tradicionale, mundësojnë një hapësirë gjithnjë e më të madhe të shprehjes e bashkë me të edhe një rrezik gjithnjë e më potencial për përdorimin e këtyre platformave për qëllime dhe komente diskriminuese apo fyese ndaj grupeve të caktuara. Duke pasur parasysh se filtrimi dhe moderimi i këtyre platformave është minimal, ky është një aspekt që i duhet kushtuar një vëmendje e veçantë.

Metodologjia

Monitorimi i medias së shkruar dhe asaj online në lidhje me përdorimin e gjuhës diskriminuese apo gjuhës së urrejtjes u krye për një periudhë 2-mujore. Ai përfshiu katër gazeta kryesore të përditshme, si dhe 2 gazeta më të vogla, po të përditshme, me qëllim që të vërehet nëse ka ndryshim standardesh përsa i përket gjuhës së urrejtjes mes dy mediave. Duke qenë se në Shqipëri nuk ka të dhëna të certifikuar publike për tirazhin, përzgjedhja u bë duke u bazuar në opinionet e vetë komunitetit të medias për madhësinë e tirazheve. Gazetat e përzgjedhura ishin: Panorama, Mapo, Shqiptarja.com, Shqip, Standard dhe Gazeta Shqiptare.

Monitorimi përfshiu edhe 3 platforma online të rëndësishme, duke u përqendruar si në përmbajtjen e prodhuar nga vetë platforma, ashtu dhe në komentet e gjeneruara nga përdoruesit. Monitorimi ka përfshirë çdo rubrikë të përmbajtjes së mediave, që nga politika e deri te sporti. Kriteret kryesore të vëzhgimit kanë qenë:

- karakteristikat e raportimit të pakicave dhe grupeve të marginalizuara;
- gjuha e përdorur;
- krijimi i stereotipeve;
- konsideratat etike në botimin e lajmeve dhe komenteve;
- filtrat vetë-rregullues ekzistues;
- “heshtja e urrejtjes” ose raportimi i munguar.

Më poshtë vijon analiza për gjendjen e gjuhës së urrejtjes në median tradicionale të shkruar, ndërsa në pjesën e dytë të monitorimit do të jenë rezultatet për monitorimin e platformave online, sipas të njëjtave kriterë.

Analiza e gjuhës së urrejtjes në median e shkruar

- **Debati politik dhe dhuna verbale në media**

Ndër vite media gjithnjë e më shumë ka qenë një pasqyruese e zjarrtë dhe e përhershme e zhvillimeve dhe debateve politike në vend, duke iu dhënë atyre pjesën e luanit në pasqyrim, pavarësisht rëndësisë së diskutueshme publike ato që kanë pasur. Madje kriteri, vlera, apo shpjegimi politik jo rrallë kanë qenë vendimtare edhe për pasqyrimin ose jo të lajmeve të fushave të tjera, si ekonomia, sociale, apo dhe kronika e zezë.

Në fakt, mund të thuhet që shoqëria shqiptare ka arritur në një fazë të skajshme politizimi, ku çdo qelizë e saj mund të konsiderohet e ngjyrosur ose e ndikuar nga ndarja e thellë politike në vend. Fakti që periudha e monitorimit ka qenë në muajt shkurt dhe mars, në një kohë që në qershor do të mbaheshin zgjedhjet e përgjithshme, të paraprirë nga një fushatë e stërzgatur zgjedhore, ka bërë që një pjesë e mirë e debatit politik në vend të ngjyroshte dhe artikujt nën vëzhgim në kuadrin e këtij monitorimi.

Ajo që mund të thuhet për pasqyrimin e politikës në gazetatat shqiptare është se ka një pasqyrim të përpiktë fjalë për fjalë të kumteve politike, aq sa mund të flitet më tepër për një transkriptim të asaj që thuhet në parlament, konferenca shtypi apo dhe intervista televizive. Në këtë aspekt, klima e ndezur parazgjedhore, me sharjet dhe akuzat e ndërsjella të politikanëve, nuk mund të mos paraqitet si e tillë në media. Cilësia e debatit politik, gjuha e përdorur, akuzat dhe etiketimet janë amplifikuar akoma më shumë me përcjelljen e tyre në media. Edhe pse kjo gjuhë tashmë nuk përbën risi për publikun shqiptar, bombardimi i vazhdueshëm dhe theksimi i këtij tipari në media padyshim që nuk ndihmon për të zbutur problemin që ekziston.

Në këtë aspekt tema kryesore që shfaqet si dhunë verbale ndaj kundërshtarit është debati mes PD dhe PS, por duke përfshirë edhe përfaqësues të partive të tjera me raste. Gjuha politike, si në parlament, ashtu dhe në raste të tjera, ka shfaqur raste ekstreme të etiketimit të kundërshtarit, të prekjes së jetës personale, sulmeve personale, etj, duke u përpjekur të përlligjë akoma më shumë ndarjen e thellë politike që ekziston në vend. Shumica e këtyre artikujve e shfaqin përmbajtjen e tyre që në titull: “Fitore 8 me 6 ndaj padrinor në Elbasan,”¹ “Populli në revoltë, me këtë bandit jo në zgjedhje,”² “Të dorëhiqen barkderrat në foto,”³ “PD: Rama është gore i zgjedhjeve,”⁴ “Rama, nxënësi i zellshëm i Jorgos,”⁵ “Bregu: Rama do vota me barcaleta,”⁶ “Berisha: Rama i dashuruar me Kolekën, t’i vërë lule te varri,”⁷ “Partia e Ramës, neopuniste, miliardere, 99-she,”⁸ “Topi: Berisha ordiner, FRD forcë fituese,”⁹ “Bulku: Rama ka bërë xheloz dhe Nastradinin,”¹⁰ “Berisha:

¹ A. Hoxha, Shqiptarja.com, 5 mars, 2013, f.6.

² Shqiptarja.com, 8 shkurt, 2013, f.7.

³ A. Hoxha, Shqiptarja.com, 1 mars, 2013, f.3.

⁴ A. Shkëmbi, Panorama, 2 shkurt, 2013, f.5.

⁵ K. Islami, Panorama, 18 mars, 2013, f.17.

⁶ Panorama, 17 mars, 2013, f.3.

⁷ F. Binjaku, Panorama, 10 mars, 2013, f.3.

⁸ K. Islami, Panorama, 4 mars, 2013, f.17.

⁹ Mapo, 27 mars, 2013, f.4.

¹⁰ Gazeta Shqiptare, 2 mars, 2013, f.6.

Edi Rama, bir direkt i Spiro Kolekës,¹¹ etj. Si mund të shihet, shumica e këtyre titujve dhe përmbajtja e artikujve janë të bazuar në luftën e deklaratave mes forcave politike apo figurave të ndryshme politike dhe nuk janë raportime të vetë medias. Megjithatë, nga titujt është e qartë që mbizotëron një agresivitet i madh, etiketim dhe paragjykim duke u nisur nga prejardhja apo jeta personale. Është po aq e qartë që media mbetet pasqyruese besnike e kësaj retorike.

Nëse do të shohim në brendinë e këtyre artikuj, shfaqet akoma më i qartë agresiviteti dhe dhuna verbale mes krahëve dhe figurave politike. Sulmet personale me anë të etiketimeve të kundërshtarit janë një tjetër shembull i dhunës verbale të pranishme në debatin politik dhe në faqet e gazetave. “*Shqipëria pa viza është Shqipëria e vërtetë, kurse Shqipëria e gënjeshtërt ekziston vetëm në psikologjinë e sëmurë të njeriut që jeton në një botë tjetër halucinante, larg botës reale,*”¹² thotë zëdhënësja e PD. Po kështu, në një deklaratë tjetër: “*Qarja përpara zgjedhjeve i është kthyer në një sëmundje patologjike, të pashërueshme,*”¹³ duke e cilësuar Ramën si “goren e vërtetë të cdo procesi zgjedhor.”¹⁴ Sulmet direkte shpesh shkojnë edhe në ndërhyrje të drejtpërdrejta apo aludime për jetën personale: “*Arsyet mund të jenë të shumta, por të gjitha ato lidhen me emrin e Ramës, me karakterin e tij anarshist, sjelljen e tij të paparashikueshme, me paaftësinë e tij të shumëllojta e të panumërta, me kompleksin e tij të inferioritetit, me teknikat makiavelike që ai përdor...deri te dëshirat e tij të pakuptueshme për “ngjyrën pink dhe ato të ylberit.*”¹⁵ Ose në një artikull tjetër: “Rama vazhdon me slogane boshe të ngjizura në dhomën e tij pink të gjumit, ndërkohë që nuk ka ende një plan për krijimin e vendeve të punës.”¹⁶

Përveç sulmeve personale dhe prejardhjes familjare, lufta politike përdor dhe aludime nacionaliste apo të lidhura me etninë kundër rivalëve. Kështu ka deklarata të tipit “*Edi Rama i ka fyer qytetarët shqiptarë më keq se ultranacionalistët serbë apo nazistët grekë,*”¹⁷ gjë që thëllon luftën politike, por ama sjell edhe implikime për ndjeshmërinë nacionale në debatin publik.

Etiketimet dhe fyerjet ndaj kundërshtarit nuk janë monopol vetëm i dy forcave kryesore politike, por në përgjithësi të politikës shqiptare. Për shembull, duke e cilësuar kryeministrin si uzurpator të shtetit, Ngjela bën thirrje ekstreme: “*Opinionit publik të ngrihet, le t’i vrasin. Ndryshe, rrini në padrejtësi. Drejtësia nuk të dhurohet.*”¹⁸ Më tej një cilësim përbuzës për pushtetin, por edhe me ngjyrimë raciste: “*Mafia është më dinjitoze se këta. Këta janë mafie, por mafie orientale, e orientit pis.*”¹⁹ Në një rast tjetër, një zyrtar i Aleancës Kuq e Zi e cilëson LSI “një zuskë që në

¹¹ V. Madani, Gazeta Shqiptare, 21 shkurt 2013, f.4.

¹² F. Drizari, “PD: Shqipëria e gënjeshtërt ekziston vetëm në paranojën politike të Ramës,” Standard, 25 shkurt, 2013, f.4.

¹³ A. Shkëmbi, “PD: Rama është gore i zgjedhjeve,” Panorama, 2 shkurt, 2013, f.5.

¹⁴ Ibid.

¹⁵ K. Islami, “Partia e Ramës neopuniste, miliardere, 99-she,” Panorama, 4 mars, 2013, f.17.

¹⁶ “Bozdo: Rama ‘mace e zezë’ për biznesin, bllokoi Gjykatën Administrative,” Gazeta Shqiptare, 27 mars, 2013, f. 11.

¹⁷ F. Mejдини, “PD nuk heq dorë nga nacionalizmi, quan antishqiptarë rivalët politikë,” Shqip, 25 shkurt, 2013, f.6.

¹⁸ “Populli në revoltë, me këtë bandit jo në zgjedhje. FBI zbardhi diskun, tani publik,” Shqiptarja.com, 8 shkurt, 2013, f.7.

¹⁹ Ibid.

moment të fundit ta dredh, siç ia drodhi LSI partisë mëmë nga doli.”²⁰

Një përjashtim që ilustron dhunën verbale në media por pa ardhur nga politikanët, por nga një gazetar/opinionist, është rasti i një artikulli nga Edison Ypi, i cili shpreh revoltën e tij ndaj shumë problemeve në politikë, por edhe në shoqëri. Mënyra e gjetur është origjinale dhe mjaft shprehëse, por gjithsesi e dhunshme: *“Kur më dalin përpara ata ndyrësira që s’dinë se ç’është atdhedashuria, pasi më vete dora te koburja dhe gishti te këmbëza, gjej me sy aty rrotull dhe e afroj me dorën tjetër një stol. Hipi më këmbë mbi stol, dhe ua zbraz koburen mbi kokë,”* apo *“Tytën e kobures ua rras mu brenda në gojën plot me bukë, dhe aty ua zbraz. Duket bukur ai shpërthim ta shohësh në film të ngadalësuar,”* dhe *“Me koburen time, ku shpesh më vete dora, bëj edhe plot punë të tjera më të vogla; Thyej brinjë, ndal zemra, plagos shpirtra, sëmur mëlçi, bllokoj gjëndra, çaj kraharorë, lag vagina, ndez ëndërra, shëroj tiroida, turbulloj tru, shkaktoj epilepsira, thaj gjymtyrë, dërrmoj kocka, çpoj kafka.”* Natyrisht që në fund autori vendos një “sqarim”: *“Koburja ime është një kobure uji që e bleva para do kohësh për këto qëllime.”* Edhe pse është e qartë që kjo është një gjetje stilistike apo shkulum sinqeriteti, gjithsesi, imazhe të dhunshme shfaqen para lexuesit dhe efekti i tyre në një shoqëri ku dhuna e vërtetë është e kudondodhur, është i diskutueshëm.

- **Gjurmët e dhunës verbale në kronikën e zezë**

Përveç politikës, dhuna verbale dhe gjuha e urrejtjes shfaqet edhe nga burime të tjera, kryesisht nga kronika e zezë. Këta lloj artikujsh shfaqin ndër të tjera edhe një tipar karakterizues të shtypit shqiptar, ku titulli zakonisht është sensacional, ndërsa përmbajtja jo gjithnjë i përgjigjet bujës së titullit. Kështu, disa nga titujt janë: *“Burri kërcënon gruan: Do të të vras,”*²¹ *“Im bir mbeti caryk gjithë jetën, vdekje monstrave,”*²² *“Abu Azam: Obama, na prit! Ty dhe Merkelin duam t’ju shohim të vdekur!”*²³, *“Spahiu: Duan kockat e qenve të ngordhur,”*²⁴ *“Nëna: Do ekzekutoj vrasësit e djalit,”*²⁵ *“Rrëfimi rrëqethës i babait vrasës: Im bir e meritonte, ajo ishte prostitutë,”* *“Dora te koburja,”*²⁶ *“Vëllai, motrës në gjyq: Ta pres kokën, na turpërove!,”*²⁷ etj. Siç mund të shihet, ka një mori titujsh shqetësues dhe bombastikë, që padyshim tërheqin vëmendjen. Gjithsesi pyetja mbetet, nëse brendia nuk e justifikon titullin, a është etike të vendosen tituj të tillë, deri diku të dhunshëm ndaj lexuesit?

Intervistimi i të afërmeve të viktimave të krimeve që bëjnë thirrje për vetëgjyqësi është një tipar tjetër i mënyrës se si gazetaret ndjekin ngjarjet e kronikës së zezë. Ndërsa shkrimet për fenomenin, analizat dhe statistikën janë më të rralla, është shumë më e lehtë të gesh intervista me familjarët e viktimave. Është mëse e kuptueshme që në këto intervista do të ketë edhe një dozë të fortë emocioni dhe ndjenje hakmarrjeje, bashkë me thirrje për vetëgjyqësi. Kështu, një nënë thotë direkt për persona të cilët i kishin dhunuar djalin: *“Dënim me vdekje për këta monstra. Gjykata i*

²⁰ F. Mejdini, “Pasha i AK: Gati për ta kthyer frontin ‘antiregjin’ në koalicion të ndershëm,” Shqip, 4 mars, 2013, f. 2.

²¹ A. Koromani, Gazeta Shqiptare, 23 shkurt, 2013, f.9.

²² E. Skënderasi, Gazeta Shqiptare, 20 mars, 2013, f.5.

²³ Gazeta Shqiptare, 4 shkurt, 2013, f.14.

²⁴ Gazeta Shqiptare, 11 shkurt, 2013, f.2.

²⁵ A. Koromani, Gazeta Shqiptare, 13 shkurt, 2013, f.9.

²⁶ E. Ypi, Mapo, 2 shkurt, 2013, f. 28.

²⁷ A. Bajrami, Panorama, 17 shkurt, 2013, f.13.

liron dhe i hedh sërish në rrugë këta persona për të kapur gjahun e radhës.”²⁸ Në një rast tjetër, gjithashtu një nënë që i kanë vranë djalin thotë: *“Nëse drejtësia nuk merr vendim maksimal, unë do t’i ekzekutoj vetë kriminelët që më vranë djalin.”*²⁹ Në këtë rast mllefi madje merr edhe trajta raciste: *“Edhe serbi që është serb nuk e bën këtë, ne nuk arrjmë kund nëse vazhdojmë të vrasim njëri-tjetrin.”*³⁰ Ky është një rast i pastër jo vetëm i dhunës verbale që lind nga dhimbja e një nëne, por edhe i pranimit dhe propagandimit të një klisheje, sipas të cilës ne po sillemi më keq se serbët, të cilët janë kryemodeli i ligësisë dhe mizorisë. Këto raste janë pasqyrim i dhimbjes njerëzore që ndiejnë të afërmit e viktimave, por a është kjo gjëja më e rëndësishme të cilën duhet të pasqyrojë gazeta? A ka interes më të lartë publik në trajtimin e ngjarjeve jo si të veçuara dhe emocionale apo në analizimin dhe raportimin për ta si përbërës të një problemi social të vazhdueshëm që thellohet?

- **Mediat dhe paragjykimet etnike**

Paragjykimet me bazë përkatësinë etnike janë ndoshta rastet e pakta kur media shqiptare ka një lloj humbjeje të ftohtësisë dhe paanësisë. Ajo që është interesante është se kryesisht kjo ndodh duke raportuar për përplasjet mes shqiptarëve dhe etnive të tjera në Ballkan, jashtë Shqipërisë, sesa për probleme që mund të ketë mes shumicës shqiptare dhe pakicave të tjera etnike në vend. Kjo ndoshta shpjegohet dhe me dinamikën e ngjarjeve, pasi këto përplasje mbeten shumë më të dukshme në vende të tjera sesa në Shqipëri. Gjithsesi, në këto raste vihet re një lloj mbajtjeje ane të mediave shqiptare, gjë që reflekton, por edhe përforcon mendimin e shumicës shqiptare.

Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe çështjet kryesore në këtë drejtim kanë qenë përplasjet mes maqedonasve dhe shqiptarëve në Shkup, kërkesat greke për trupat e ushtarëve dhe lëvizje politike nga Agimi i Artë. Edhe pse në shumicën e rasteve është raportim i thjeshtë ngjarjesh, fjali të caktuara “tradhtojnë” deri diku ndjenjën e brendshme të gazetarit që raporton. Për shembull, një raportim për një miting të shoqatave të Vorio Epirit në Athinë mbyllet kështu: *“Ironike është fakti se në të njëjtën ditë më 17 shkurt shqiptarët festojnë Pavarësinë e Kosovës dhe mbajtjen e ligjëratave të para të Universitetit të Tetovës, ndërsa një grup grekësh ekstremistë përkujtojnë një ëndërr që nuk mund të realizohet asnjëherë, atë të aneksimit të jugut të Shqipërisë.”*³¹ Edhe pse në dukje një renditje faktesh, kjo fjali gjithashtu vë përballë dy nacionalizma, duke theksuar se ai shqiptar tashmë ka triumfuar, kurse ai grek është i dështuar.

Po kështu, raportimi për gërmimet për varret greke në përgjithësi ka qenë një raportim i thjeshtë dhe i ftohtë. Megjithatë, citime të banorëve të trevave ku gërmohet sjellin mendimin aspak të mirë për fqinjët grekë: *“Ky veprim është i qëllimshëm...Ne e varrosëm e tani greku kërkon të na bjerë me gur pas koke, duan eshtra se ata, edhe eshtrat tona po të kenë mundësi, i marrin.”*³² Edhe pse ky është zëri i disa banorëve dhe jo zëri i medias apo qëndrimi zyrtar, sërish një pasqyrim i tillë krijon një situatë paranoje mes dy etnive.

Në një nivel më të përgjithshëm, përkatësia etnike shpesh është e pranishme për një klasë të tërë

²⁸ E. Skënderasi, “Im bir mbeti cyryk gjithë jetën, vdekje monstrave,” Gazeta Shqiptare, 20 mars, 2013, f.5.

²⁹ A. Koromani, “Nëna: Do ekzekutoj vrasësit e djalit,” Gazeta Shqiptare, 13 shkurt, 2013, f.9.

³⁰ Ibid.

³¹ A. Llalla, “Vartësi i Kserës në tubimin e Athinës,” Shqiptarja.com, 19 shkurt, 2013, f.10

³² D. Cule, “Boboshticë, banorët kundër gërmimeve për varret greke,” Panorama, 14 shkurt, 2013, f.16.

veprimesh apo aktiviteteve ku etnia nuk është aspak faktori kryesor. Për shembull, hasim tituj të tillë si: “Braçe: Porto Romano nën pushtimin serb”³³ apo “Grekët monopolizojnë tregun,”³⁴ ndërkohë që brendia e artikujve sqaron përse bëhet fjalë dhe etnia nuk është elementi më i rëndësishëm. Gjithashtu, në një artikull tjetër hasim një paragjykim ndaj shqiptarëve dhe klishesë së tyre për kriminelë: “*Mes miliona britanikëve apo të huajve që jetojnë në Angli, ku kriminaliteti i tyre nuk është i vogël, policiz londineze ka ndarë veçmas 18 më të kërkuarit. Shqiptarët nuk mund të ishin të papërfshirë.*”³⁵ Të gjitha këto raste, megjithëse të izoluara, tregojnë se pavarësisht përpjekjeve të bëra dhe kujdesit të treguar, klishetë, stereotipet dhe paragjykimet arrijnë të filtrojnë në raportimin e lajmeve.

Këto paragjyqime, stereotipe dhe klishe bëhen akoma më të dukshme në hapësirat ku diçka e tillë është deri diku e përligjur: në hapësirën e editorialeve, komenteve dhe analizave. Kjo është një dukuri që vihet re si në analizën e ngjarjeve apo fenomeneve në vend, ashtu dhe në ngjarjet jashtë kufijve. Kështu dy editoriale për problemet mes etnive në Maqedoni shprehin hapur mendimin e autorit për inferioritetin e maqedonasve përballë shqiptarëve: “*Kjo histeri goditjesh ndaj shqiptarëve në fakt është kompensim i këtij inferioriteti, prandaj kot mund të presim që të shohim sot flamuj të djegur grekë, bullgarë a serbë. Vetëm flamujt e djegur shqiptarë po ushqejnë inferioritetin dhe qyqanllëkun maqedonas.*”³⁶

Veçanërisht provokuese në këtë aspekt ka qenë vizita dhe intervistat në shtyp të Kristo Papisit, të cilat ngjallën polemika të shumta dhe reagime në shtyp. Disa nga këto editoriale dhe analiza e kapërcejnë kritikën ndaj veprimeve të Papisit dhe kalojnë në përgjithësime të popullit grek dhe shqiptar, ku kontrasti është i qartë: “*Edhe pse grekët i kanë bërë shumë të këqija kombit shqiptar, përsëri ne shqiptarët i kemi falur, jemi treguar tolerantë dhe këtë e kemi bërë për paqen e dy popujve, jo për frikë, sepse Kombin shqiptar nuk e tremb një Greqi e shpartalluar ekonomikisht dhe psikologjikisht.*”³⁷ Në disa raste gjuha bëhet më e ashpër akoma, duke diferencuar me përbuzje dhe etni të tjera: “*Ka edhe ca ‘xacër’ në disa rrethina të Shqipërisë që thonë: ‘Po, ne jemi llaci-faci, por jemi edhe grekë.’*”³⁸ Ose në një rast tjetër, ku autori pretendon se po analizon llojet e ndryshme të nacionalizmit: “*Sllavët kanë për zemër shprehjen: ‘Shqiptar i mirë është shqiptari i vdekur,’ ndërsa grekët nga duan për nevoja më pragmatiste, ‘të na rrjepin lëkurën e të na bëjnë lidhëse këpucësh,’*” duke konkluduar se në rastin e shqiptarëve nacionalizmi nuk është retorikë, por buron nga vuajtjet tona, pra si i tillë është i justifikuar.³⁹

Këto mendime apo shprehje, edhe pse të mbrojtura nën petkun e editorialit, vështirë të jenë konstruktive, përfaqësuese të tërë shoqërisë, apo analizë e plotë e problemeve që ekzistojnë në shoqëri. Më tepër, këto shfaqen si mbizotërim i mendimit të shumicës ndaj pakicës, si kurorëzim i një nacionalizmi të mirë mbi nacionalizmat e këqij dhe shovinistë të fqinjëve, si një ndarje e përligjur mes komuniteteve dhe popujve. Megjithatë, duhet theksuar se këta artikuj janë raste të izoluara, por gjithsesi një shfaqje serioze që duhet të trajtohet si e tillë.

³³ G. Kondi, “Braçe: Porto Romano nën pushtimin serb,” Shqiptarja.com, 1 shkurt, 2013, f.7.

³⁴ Shqiptarja.com, 5 mars, 2013, f.15.

³⁵ Shqiptarja.com, 5 shkurt, 2013, f.15.

³⁶ E. Azemi, “Inferioriteti maqedonas i mbështjellë me antishqiptarizëm,” Mapo, 6 mars, 2013, f.11.

³⁷ A. Llalla, “Replikë çjerrjeve luftë nxitëse të Kristo Papisit,” Shqiptarja.com, 3 shkurt, 2013, f.16.

³⁸ P. Hallko, “Ai nuk është nazist,” Gazeta Shqiptare, 2 shkurt, 2013, f.33.

³⁹ G. Sala, Shqip, 16 shkurt, 2013, f.9.

- **Sulmet personale në media**

Një tjetër prirje që mund të klasifikohet si nxitje e gjuhës së urrejtjes është sulmi i personave të ndryshëm publikë jo duke u nisur nga puna apo argumentat e tyre, por nga mendimi personal apo jeta e tyre. Këta artikuj sërish vijnë kryesisht në formën e editorialeve apo analizave, jo si raportime të ngjarjeve nga vetë gazeta. Megjithëse gazeta vetë nuk është drejtpërdrejt e përfshirë në këtë dukuri, është për të ardhur keq që pas dy dekadash zhvillimi të shtypit shqiptar ende has në artikuj ku jeta personale dhe prejardhja janë më të rëndësishme se çdo gjë tjetër.

Disa nga këto shkrime, pavarësisht se mund të paraqesin argumente ose opinione të ndryshme, humbin cilësinë dhe forcën e tyre bindëse në momentin që autorët përfshihen dhe personalisht. Kështu, në një analizë për intervistën e bërë nga Artur Zheji me Kristo Papasin, përmendet ndër të tjera se: *“Zoti Zheji mund të punojë në media, mund të quhet dhe gazetar meqë punon në një televizion, por kjo nuk e kalon dot në hije faktin që ka mbërritur aty vetëm se është djali i një gjuhëtari të njohur dhe aktoreje që ka luajtur (filma) me rusët.”*⁴⁰ Pavarësisht vërejtjeve që autori mund të ketë ndaj intervistës, ta shpjegosh cilësinë e saj me prejardhjen familjare të Zhejit si të vetmen meritë nuk është as etike, as argument i qëndrueshëm. Më tej autori vazhdon me sulme të tjera: *“Zoti Zheji është vulgar nga natyra në komunikimin e përditshëm...”* apo *“Zoti Zheji ishte aq i trembur përballë një injoranti sa iu desh të mbrohej duke thënë se ai nuk ishte politikan, por gazetar.”*⁴¹

Në po të njëjtën linjë, ndoshta me një gjuhë edhe më ekstreme, gjejmë një shkrim të Edison Ypit, kundër një sondazhi online të njëres prej gazetave të përditshme shqiptare, ku përveç kundërshtimit të sondazhit kalohet dhe në fyerje të drejtpërdrejta ndaj drejtueses së gazetës me fjali si këto: *“Një nga këto sajesa truthara, këto mjete mendjempira, këto leva zemërgurta, është sondazhi i shqiptarja pik kom,”* apo *“Tabloja kontradiktore nuk të lë të dyshosh për një manipulim brenda një manipulimi, një gënjeshtre brenda një gënjeshtre, bërë nga një femër e pasuksesshme si gazetë, ndaj dy femrave të suksesshme në politikë.”*⁴²

Po kështu, i njëjti autor, i njohur për gjuhën e vet pasionale, karakteristike dhe aspak korrekte, shpreh mendimin e vet për gjendjen e medias shqiptare, duke veçuar një emision të ri, sipas tij të veçantë: *“Paçja mëngjesore e Hervin Culit është i vetmi oaz antikonformizmi të pastër në krejt saharën mediatike shqiptare, plot me beduinë të etur që gjuajnë kokrrën e lekut si pikën e ujit dhe deve gungaçe që presin të martohen përmes ekranit.”*⁴³ Sidomos fjalia e mbylljes e shpreh më së miri mendimin e tij dhe propagandon këtë ndarje të thellë në cilësinë e programeve në media, gjithnjë sipas autorit: *“Banakët e tyre janë hale, paçja juaj është qiell. Ju jeni të pastër, ata janë të pisët. Ju jeni plot dritë, ata janë obskurë. Ju jeni të drejtë ata janë të kërrusur. Ju jeni të shëndetshëm, ata janë të sëmurë. Ju jeni të bukur, ata janë për ibret. Ju jeni të gjallë, ata janë të vdekur.”*⁴⁴ Sigurisht që autori ka të drejtën e padiskutueshme të thotë mendimin e vet për programet në median shqiptare dhe të shprehë preferencat e tij. Megjithatë, gjuha e tepruar dhe aspak korrekte, edhe pse pjesë e pandarë e shkrimeve të tij, ndoshta jo gjithnjë mund të

⁴⁰ C. Hoxha, “Një intervistë e dështuar,” Standard, 4 shkurt 2013, f.11.

⁴¹ Ibid.

⁴² E. Ypi, “Spiropali, Bazhdari, Shqiptarja,” Mapo, 7 mars, 2013, f.10.

⁴³ E. Ypi, “Hervin & friends,” Mapo, 22 mars, 2013, f. 10.

⁴⁴ Ibid.

justifikohet me lirinë e shprehjes, ose të paktën jo në çdo rast.

- **Media dhe qëndrimi ndaj historisë dhe historianëve**

Në të njëjtën vazhdë të shkrimeve argumentuese pa argumenta të qëndrueshme janë dhe disa nga shkrimet e bëra kundër historianit Oliver Jens Schmitt, një shënjestër tashmë e përhershme për disa opinionistë apo historianë në median shqiptare. Ndërkohë që një debat publik për të kaluarën tonë, i bazuar në fakte, argumenta dhe të dhëna shkencore do të ishte i shëndetshëm, në shumë raste mendimet e botuara në shtypin shqiptar udhëhiqen më tepër nga emocionaliteti dhe sedra kombëtare, duke kaluar edhe në sulme direkte ndaj historianit në fjalë. Gjatë periudhës së monitoruar janë vërejtur disa artikuj kundër Schmitt dhe megjithëse disa prej tyre janë botuar nga historianë apo akademikë, është e vështirë të gjesh një argumentim të këtij rangu në këta artikuj.

Kështu, një nga artikujt thotë: “Lehtësia me të cilën autori ka shtjelluar këtë temë, më shumë se ajo e autorëve të teksteve fikzionale, që nuk e kanë për gjë të trillojnë, të krijojnë kundërthënie me fjalët e veta, të përrallisnin me seriozitet pompoz për gjëra të vogla, që janë të njohura dhe monotone për edhe të ‘citojnë’ nga pak tekstet e huaja, gjasme sipas poetikës postmoderne.”⁴⁵ Kjo përbuzje dhe paragjykim i hapur për veprën e Schmitt shkon deri aty sa autori i shkrimit e akuzon hapur Schmitt edhe për “plagjarizëm me marifet,” duke cituar si të vetmin argument një fjali të Schmitt dhe një nga një historian tjetër. Fjalja është: “*Si perandori e karakterizuar nga tradita shtetërore romake, besimi ortodoks dhe gjuha greke, Bizanti...*”⁴⁶ Kjo fjali e Schmitt, për hir të vërtetës, është shumë pranë fjalisë tjetër të cituar nga një burim i ndryshëm. Po për hir të vërtetës autori i shkrimit duhej të ishte aq i drejtë sa të pranonte se kjo është një fjali me një njohuri aq të përgjithshme sa që edhe nxënësi më i dobët i degës së historisë do ta formulonte pa asnjë problem dhe si e tillë nuk mund të merret karakterizuese për të justifikuar një akuzë aq të rëndë sa plagjarizmi akademik.

Natyrisht që strumbullari i shkrimeve ndaj Schmitt është armiqësia e supozuar e historianit ndaj shqiptarëve dhe preferenca për serbët, në këtë ndarje dhe luftë të përhershme mes dy popujve. Ndërkohë që historianët dhe akademikët janë ata që duhet të hedhin dritë mbi historinë me argumenta, ajo që i serviret publikut të gjerë në shkrimet e tyre janë thjesht etiketime dhe paragjykime për Schmitt, të cilat mbajnë gjallë argumentin e paranojës së kësaj beteje të përjetshme për jetë a vdekje që shqiptarët duhet të kenë me serbët. Kështu gjejmë fraza të tilla si: “*disponimi armiqësor i Schmitt ndaj shqiptarëve nganjëherë shpërthen edhe krejt pa takt, gati irracional*”⁴⁷ apo “*interpretimi spekulativ i Schmitt-it përpiket ta transmetojë pikërisht mesazhin për shqiptarët si barbarë, të pasionuar pas armëve dhe vdekjes.*” Artikulli kalon edhe në fyerje të hapura ndaj punës së historianit: “*Kaq të pavërteta në një paragraf, kjo është një prirje perverse e një historiani, e denjë për t’u neveritur prej saj.*”⁴⁸ Si për t’i vënë vulën mendimit të tij për veprën e Schmitt autori e mbyll artikullin me një gjuhë aspak korrekte, përcmuese dhe pa argumenta për Schmitt: “*Sidoqoftë, përfundimi ynë nga leximi i gjithë këtij libri është se ky historian nuk mund të shkruajë histori korrekte, sepse është shumë i ngarkuar me paragjykime ndaj shqiptarëve. Ai tashmë ka profilizuar një disiplinë të re që mund të emërtohet si*

⁴⁵ M. Krasniqi, “‘Shmitologjia’ si disiplinë e të pavërtetave kundër shqiptarëve,” Standard, 20 shkurt, 2013, f. 10-11.

⁴⁶ Ibid.

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ Ibid.

Shmitologjia dhe e cila është ngritur për të fabrikuar kastile të pavërteta kundër shqiptarëve. E gjitha është për të ardhur keq.”⁴⁹ Në fakt është për të ardhur keq që në shtypin shqiptar ka vend për artikuj të tillë, të cilët i përgjigjen veprës shkencore me sharje dhe etiketime personale, ndërsa argumentave me paranojë dhe paragjykime.

Në po të njëjtën vazhdë është dhe një artikull tjetër, i cili përqendrohet jo vetëm te Schmitt por edhe te historianë të tjerë, argumentat e të cilëve nuk janë pëlqyer nga autorët e disa shkrimeve. Kështu, një artikull e cilëson si të dobët librin e Schmitt për Shkënderbeun, ndërsa për një historiane tjetër ka vetëm fyerje personale: “*Nathalie Clayer, me sa kemi lexuar është një inxhinierë gjeologe e specializuar për orientalistikë që te ne ka gjetur disa sponsorë që janë mësuar të shesin dushk për gogla. Madje tezat e saj absurde rreth lindjes së një kombi shqiptar mysliman deri diku varen dhe përputhen me këndvështrimin e studiuesit serb Alexandre Popovic, i cili është dhe burri i saj.*”⁵⁰ Duke i cilësuar të dy këta autorë si mosnjohës të historisë shqiptare, tendenciozë dhe me një ndikim të fortë serb, artikulli mbyllet duke thënë: “*Që një sharlatan i tillë të shkruajë prej nadjes deri në darkë historina të tutkallta e bihude për do mendje kakarece, nuk na ban aspak përshtypje, por kur një individ kësisoji hipën në një katedër studimesh shqiptare dhe e rren mendja se po na dëfton kush kemi qenë e kush jemi, pa njohur as abc-në e metodologjisë së shkencës historike, kjo gjë tregon dekadencën e frikshme të albanologjisë së sotme.*”⁵¹ Kjo fjali e përmbledh më së miri frymën e fortë kundër veprës së Schmitt në disa qarqe opinionistësh apo studiuesish shqiptarë. Ndërkohë që kjo frymë kundërshtimi është mëse e qartë, shtjellimet e tyre për argumentat pse Schmitt apo historianë të tjerë gabojnë në fakt nuk janë aq të qarta dhe në shumë raste autorët sjellin si të vetmet argumente varësinë e historianëve nga sllavët, cilësinë e dobët të studimeve akademike në vende si Austria, Gjermania, apo Franca, apo dhe lidhjet personale të historianëve apo nëse ata dinë apo nuk dinë shqip. Argumenta që në fakt vështirë të maten me një punë të mirëfilltë akademike, cilësore apo jo, dhe që ndoshta nuk duhen adresuar në faqet e gazetave, para gjithë popullit, pa pasur një mendim racional dhe të argumentuar.

Përballja me veprën e Schmitt kryesisht, por edhe me atë të historianëve të tjerë që kanë studiuar Shqipërinë nxjerr në pah edhe një tipar tjetër të kësaj përballjeje me historinë tonë dhe mënyrën se si e shohim atë. Më konkretisht, kjo përplasje, akademike apo jo, vë në dukje dhe një lloj kompleksi inferioriteti të historianëve shqiptarë, momentin që ata nuk citohen në veprat e historianëve të huaj. Kështu, një nga autorët e shpall që në titull të artikullit të tij këtë mendim për historianët e huaj: “Schmitt-i dhe dekadencia e frikshme e studimeve historike jashtë Shqipërisë.” Ashtu si shtjellohet dhe në artikull, i cili u përmend më në hollësi më sipër, autori shpreh mendimin se albanologjia e sotme ka degraduar në krahasim me kohët e Jokl-it dhe brezit më të hershëm të albanologëve, ndërkohë që studiuesit e sotëm si Schmitt nuk dinë as shqip dhe nuk citojnë as historianë shqiptarë. Në një artikull tjetër, një historian shqiptar cilëson si një mangësi të madhe të veprës së Schmitt faktin që autori nuk citon “*veprën e kolosëve të albanologjisë prof. Eqrem Çabej dhe prof. Aleks Budës.*”⁵² Gjithashtu, studiuesi shqiptar i kundërvihet një pohimi të Schmitt për mangësinë e të dhënave për periudhën ilire me rreshtimin

⁴⁹ Ibid.

⁵⁰ A. Ndreca, “Schmitt-i dhe dekadencia e frikshme e studimeve historike jashtë Shqipërisë,” Mapo, 16 shkurt, 2013, f.31.

⁵¹ Ibid.

⁵² M. Korkuti, “M. Korkuti: Oliver Schmitt ka teori pansllaviste,” Gazeta Shqiptare, 14 shkurt, 2013, f. 16-17.

e një sërë veprave të botuara në periudhën komuniste, të cilat fare mirë mund të kenë qenë të ngjyrosura me propagandën e kohës dhe ndoshta dhe arsyeja që studiuesi austriak nuk i ka përfshirë ato në argumentat e tij. Gjithsesi, për këto arsye dhe disa të tjera, historiani shqiptar arrin në argumentin se *“Shmitt nuk ndjek rrugën e argumentimit, por atë të etiketimit, se këto janë pikëpamje nacionaliste, shoviniste, staliniste, apo qëndrime të historianëve emocionalë dhe komunistë”*⁵³ dhe e përmbyll artikullin duke thënë se *“ky është një variant i ri i teorisë pansllaviste të Shelishevit për origjinën e shqiptarëve.”*⁵⁴ Zelli për të kritikuar veprat e studiuesve të huaj vetëm se nuk janë bazuar në vepra shqiptare tregon edhe një lloj rezistence për të pranuar mendime të ndryshme nga ato që janë ngulitur në historiografinë shqiptare, por edhe në opinionin publik shqiptar, së bashku me një luftë të hapur dhe mungesë tolerance dhe përthithjeje të argumentave të reja që mund të shfaqen në këtë fushë. Edhe pse media nuk është direkt përgjegjëse për këtë gjë, por është më tepër një platformë diskutimi, diskutimi në këtë lëmë ka mbetur disi i njëanshëm, pasi dominojnë zërat e njëjtë.

- **Media dhe ideologjia**

Një prirje që vihet re kryesisht në editoriale, analiza, apo artikuj të gjatë në formë eseje është sulmimi i ideologjive, bindjeve politike, e më rrallë edhe bindjeve fetare apo orientimit seksual. Sigurisht, duhet theksuar se këta artikuj janë të firmosur krejtësisht nga autorë, studiues, apo publicistë të ndryshëm dhe asnjëherë nga stafi editorial i gazetave. Megjithatë, duke pasur parasysh përçarjen që disa nga këta artikuj priren të propagandojnë, një balancë më e mirë ndaj lirisë së fjalës dhe përgjegjësisë së saj do të ishte më e përshtatshme në këtë rast.

Një nga shembujt më të spikatur në këtë drejtim është një artikull i gjatë me titull *“Komunizmi, çfarë është?”* i botuar në gazetën *“Standard”* në datë 22 shkurt 2013 nga prof.dr. Isuf Luzaj. Artikulli shpreh bindjen e palëkundur të autorit që komunizmi është një nga shpikjet më djallëzore, më çnjerëzore dhe më të dëmshme për njeriun. *“Komunizmi është një filozofi jete antinatyrale, kundër ligjeve të natyrës, e dënuar të falimentojë, sepse është false me premisat logjike, e gabuar dhe pa themel në arkitekturën e ideve dhe fikSION imagjinate të sëmure.”*⁵⁵ Ky është paragrafi hapës i artikullit, ku autori shfaq pa asnjë dyshim qëndrimin e tij ndaj komunizmit si ideologji, me një dozë të fortë emocioni ndaj saj.

Ky kundërshtim vazhdon me analizën e kushteve historike që sollën lindjen e komunizmit, duke theksuar gjatë gjithë kohës, po me aq forcë, se kapitalizmi, paçka të metat që ka, nuk mund të krahasohet për nga superioriteti me komunizmin. *“Të refuzosh kapitalizmin e demokracive për të metat e tij është një lloj sikur një vashëz refuzon të martohet me një djalë me cilësi mendore, shpirtërore, morale ose punëtore, sepse djali i ka flokët e kuq, ose sytë të verdhë, ose hundën e madhe!”*⁵⁶ Pra, autori jo vetëm që e bën të qartë përbuzjen e tij për komunizmin, por dikton kapitalizmin si zgjedhjen e vetme praktike, por edhe morale për shoqërinë.

Së fundmi, autori jep edhe një lloj *“zgjidhjeje finale”* për komunizmin, duke përdorur metaforën e sëmundjes së kancerit për të. *“Për të shëruar popullin shqiptar nga kanceri i kuq duhet një*

⁵³ Ibid.

⁵⁴ Ibid.

⁵⁵ I. Luzaj, *“Komunizmi, çfarë është?”* Standard, 22 shkurt, 2013, f. 16-17.

⁵⁶ Ibid.

*proces intensiv dhe ekstensiv paralel:A) Radioterapi-kimioterapi dhe ndërhyrje kirurgjike, rrënjësore, si pastrimi i trurit, nervave, gjakut, xhinit deri në mikrokozmin më të thellë. Faza e dytë është një terapi higjienike, duke i larë trurin popullit nga kanceri i kuq me anë të edukatës në të gjitha mjetet e saj: shkollat, librat, radio-televizioni, revista, gazeta, etj. Duke pastruar bibliotekat nga leukemia që i mbulon dhe duke rimbushur bibliotekat me libra të qytetërimit euro-amerikan...*⁵⁷

Në po të njëjtën linjë, megjithëse shumë më pak ekstremiste, është një artikull kundër Rexhep Qoses dhe një interviste të tij në median shqiptare, i cili etiketohet që në titull si cytës. Në artikull ka fjali të tilla si: “Mënyra sesi gjykon, si shkruan, si ofendon pa pikë droje, të bën të mendosh se stalinisti kulturor është Qosja,” apo “nuk ka shumë ndërhyrje kundër të thënave e të pathënave të Rexhep Qoses, nuk ka shumë reagime të fora nga opinioni publik, përkundrazi, ka një lloj mikpritjeje për përrallat e tij me armiqtë dhe heronjtë të popullit, ka një humus mikpritës ndaj parullave enveriste të tij dhe madje edhe nderime që nuk i bëjnë nder kombit shqiptar.”⁵⁸ Në fakt, autori paraqet gjatë gjithë artikullit kundërshtimin me këndvështrimin dhe pikëpamjet e Qoses, gjë krejtësisht e pranueshme, por gjuha e përdorur dhe etiketimet politike nuk mungojnë, gjë që zbeh vlerën e argumenteve.

Siç u përmend, artikujt e cituar ishin të llojit editorial, ku autorët dhe jo redaksia mbajnë përgjegjësinë për ato që shkruhen. Megjithatë, duke ruajtur të drejtën e autorit për të pasur bindjet e veta politike, qofshin ato dhe fanatike, një gjuhë kaq e ashpër, përbuzëse, dhe militante ndaj komunizmit në një kohë kur pretendohet për demokraci, liri mendimi dhe tolerancë për çdo mendim ndryshe, të shtyn të vësh disa pikëpyetje për këtë liri që gazeta dhe autorët i japin vetes.

- **Media dhe qëndrimi ndaj fesë**

Një tjetër temë që është rimarrë gjatë kësaj periudhe në shtypin shqiptar është edhe diversiteti fetar, kryesisht e nisur nga kërkesat për germime në fshatra të jugut për trupa të ushtarëve grekë. Mënyra se si pasqyrohet dhe portretizohet secila fe dhe marrëdhënia e shqiptarëve me besimin është një test më vete për median dhe shoqërinë shqiptare.

Ndërkohë që shumica e raportimeve për temat e lidhura me fenë janë thjesht raportim ngjarjeje, pa ndonjë ngjyrim të caktuar, editorialet, analizat dhe deri diku dhe intervistat pasqyrojnë një gjuhë më pak asnjëse dhe deri diku problematike. Kështu, një editorial i Kosta Barkës është ndërtuar mbi krahasimin e kundërshtimit të kësaj periudhe ndaj disa veprimeve të kishës ortodokse në Shqipëri me persekucionin fillestar ndaj krishtëritimit në fillimet e veta. Ndër të tjera autori thotë: “kjo luftë mbetet vetëm një përpjekje mizore e paskrupullt e qëllimeve të ulëta të kastave të caktuara, në kurriz të gjësë më të shenjtë që ka njeriu, besimit të Zotit.”⁵⁹ Po kështu, tituj të tillë si “Janullatos: Po sulmojnë Kishën nën maskën e artit”⁶⁰ “Nuk jemi në komunizëm, edhe Enveri respektoi Shën Kozmain,”⁶¹ dhe “Janullatos në Shqipëri për interesat e Greqisë,”⁶²

⁵⁷ Ibid.

⁵⁸ A. Nikolla, “Cytësi Rexhep Qosja dhe humusi i cuditshëm mikpritës,” Mapo, 8 shkurt, 2013, f.11.

⁵⁹ K. Barka, “Sulmi ndaj Kishës Ortodokse, riciklim i persekucionit antik ndaj Krishtëritimit,” Panorama, 10 shkurt, 2013, f. 13.

⁶⁰ Mapo, 6 shkurt, 2013, f.8.

⁶¹ A. Jole, Gazeta Shqiptare, 6 shkurt, 2013, f.3.

⁶² A. Zheji, Gazeta Shqiptare, 1 shkurt, 2013, f.6.

dëshmojnë jo vetëm për konfliktin ekzistues brenda vetë kishës ortodokse, por edhe prirjen të transmetojnë viktimizimin që vetë kisha ka paraqitur nga ana e saj. Edhe pse kisha ka çdo të drejtë të mbajë qëndrimin e vet për ngjarjet që rrodhën në atë periudhë, botimi fjalë për fjalë i fjalimeve të kryepeshkopit apo i editorialeve që e mbështesin atë sjell një pasqyrim të njëanshëm të situatës dhe bën që të dëgjohet vetëm njëra anë e përfaqësuesve të besimit në vend. Në fakt, disa gazeta kanë botuar edhe një intervistë televizive të At Nikolla Markut, kundërshtar të hapur të Janullatosit për shumë vite. Në këtë intervistë ai vazhdon të kundërshtojë hapur kryepeshkopin, me pretendimin se ai nuk është simbol i Kishës Ortodokse shqiptare dhe se në fakt i shërben vetëm grekëve: *“ai akoma nuk ka mbaruar detyrat që i ka dhënë shteti grek në Shqipëri për çështjen e Vorio-Epirit, për çështjen e memorialëve grekë, pra ai është përfaqësues i ushtrisë helenizuese në Shqipëri, gjë që nuk funksionon më, vetëm se janë ato kokat e nxehta në Greqi që e ushqejnë këtë iluzion, bashkë me Janullatosin.”*⁶³ Në fakt, media në këtë pikë duket thjesht se është përçuese e debatit të brendshëm dhe publik që bëhet në kishën ortodokse, ku ka dhe një qëndrim anti-grek, i cili, për natyrën e vetë saj, në media amplifikohet. Megjithatë, në këto rrethana, ajo që mungon në media është një analizë më e ftohtë, e distancuar dhe e jashtme, e cila të shpjegojë përse-të e këtij konflikti, pa rigjallëruar në publik ndjenjën e konfliktit fetar dhe etnik në një moment të brishtë.

Nga ana tjetër, ka dhe raste kur komunitete të ndryshme luftojnë njëri-tjetrin, deri në të drejtat themelore të secilit. Shembulli më tipik është ai i komuniteteve fetare kundër komunitetit LGBT, një betejë që zhvillohet në fakt në çdo vend të botës. Në përgjithësi raportimet në media në këtë fushë kanë qenë korrekte pasi media është mjaftuar me përcjelljen e thjeshtë të deklaratave të secilit komunitet, pa mbajtur anë specifike. Megjithatë, gjatë këtij monitorimi është vërejtur edhe një analizë e një përfaqësuesi të klerit, mjaft aktiv në media gjithashtu, për kërkesat e personave LGBT. Analiza jep ndër të tjera mendimin personal dhe atë të komunitetit fetar që autori i artikullit përfaqëson:

*“Me kalimin e viteve LGBT, në emër të një shoqërie të hapur, që po kthehet në një dogmë moderne, do të fitojnë kauzën e adoptimit të fëmijëve dhe kauza të tjera. Megjithatë, kurrë nuk do të fitohet një kauzë ndër këto kauza të shumta, rritja e një fëmije me fjalët nanë dhe babë, pasi, nëse do heqin fjalët burrë dhe grua nga Kodi i familjes nuk kanë më kuptim as fjalët nanë dhe babë. Do të përdoren ndoshta emërtimet prindi A e prindi B, që shkojnë mirë në emërtimin e sendeve, në matriculimin e shtazëve, në identifikimin e të burgosurve nëpër burgjet diktatoriale, por jo për personat. Përmbysja e këtij rendi të natyrshëm, të shkruar në thelbin e njeriut, do të ketë pasoja të mëdha në jetën e njerëzve, po aq sa kanë divorcet, abuzimet me fëmijët, aborti etj. Sado të përpiqet të shprehet një atësi (brenda një çifti homoseksual) ajo kurrë nuk është e mundur pa një amësi dhe anasjelltas. Amësia ka kuptim dhe merr trajtë vetëm pranë një atësie. Është si të thuash që nuk e ke idenë e fjalës ngrohtë nëse nuk ekziston e ftohta.”*⁶⁴

Edhe pse i paraqitur në mënyrë elegante, qëndrimi i autorit sërish shkon në diskriminim të komunitetit LGBT, duke mos pranuar të drejtën e tyre për të qenë prindër si diçka që shkon përtej të natyrshmes dhe si e tillë një betejë që vështirë se mund të fitohet. Artikulli mbyllet duke thënë: *“Triumfoi duke u realizuar në trupin e një gruaje nga dashuria me burrin e saj, e vetmja dashuri e mundshme, e frytshme.”* Shkrimi përforcon mendimin dominues që ekziston në shoqëri

⁶³ A. Zheji, “Janullatos në Shqipëri për interesat e Greqisë,” Gazeta Shqiptare, 1 shkurt, 2013, f.6.

⁶⁴ Dom Gj. Meta, “LGBT dhe dashuria e frytshme,” Mapo, 9-10 mars, 2013, f. 28.

që familja tradicionale është e vetmja rrugë, duke krijuar idenë se gjithçka tjetër është përtej së drejtës, normales, së natyrshmes. Natyrisht që secili komunitet valëvit flamurin e tij dhe ruan pozicionet e veta, por kur kjo përdoret në media, në një platformë që supozohet të përfaqësojë interesat e gjithë shoqërisë, sigurisht që shprehja dhe balancimi i këtyre pozicioneve marrin një vlerë më të madhe dhe të veçantë.

- **Raportimi i diversitetit: një qasje pozitive**

Në fakt, nuk mund të thuhet që komunitete të ndryshme nuk kanë gjetur përfaqësim në median gjeneraliste shqiptare. Pavarësisht se nuk ka një qëndrim pro-aktiv nga gazetatat në këtë drejtim dhe cilësia e pasqyrit është e diskutueshme, nuk mund të thuhet që komunitete të caktuara nuk gjejnë vend në hapësirën e faqeve të gazetave. Për shembull, gjatë këtij monitorimi, ka disa raportime për komunitetin LGBT dhe betejën e tyre për të drejta më të gjera ligjore. Këto shkrime kanë nisur kryesisht si pasojë e deklaratave ekstremiste të një politikani që është kundër të drejtave LGBT dhe kundër abortit, por janë pasuar edhe nga shkrime të tjera që pasqyrojnë edhe mendimin e shoqatave që mbrojnë këto të drejta.⁶⁵ Gjithashtu, një artikull tjetër bën një raportim më të thelluar për të drejtat e LGBT-së, qëndrimet e politikanëve, si dhe qëndrimin e komuniteteve fetare kundër këtij komuniteti, duke bërë një analizë të paanshme dhe të distancuar për pozicionin e secilit komunitet.⁶⁶ Po kështu, gjatë kësaj periudhe, i vetmi artikull mbi romët është pozitiv, pasi paraqet përpjekjet e një të riu rom për të vendosur një monument kushtuar romëve në bashkinë e Tiranës, ku vetë i riu rom shpjegon pozicionin, arsyet dhe rëndësinë e këtij memoriali që ai dëshiron të vendosë.⁶⁷

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar për ngjarje apo incidente të ndryshme me minoritetin grek, në lidhje me peticionin për rishikimin e teksteve historike dhe zhvillimet në Maqedoni, ka pasur disa analiza, intervista dhe editoriale që analizojnë këto zhvillime. Në shumicën e rasteve këto shkrime kanë sjellë një pamje komplekse të situatës, duke paraqitur të dyja anët e medaljes. Për shembull, shkrimi “Turqia prapë kërkon rishikimin e teksteve”⁶⁸ paraqet justifikimin për veprimet e Ministrisë së Arsimit të Kosovës, kërkesat e qeverisë turke, si dhe pikëpamjen e autorëve të tekstit dhe të historianëve të tjerë.

Gjithashtu, në lidhje me shfaqje të ndryshme të nacionalizmit në Shqipëri, në politikë, në marrëdhënien me fenë, apo dhe në futboll, ka pasur reagime të ndryshme duke dënuar këto shfaqje ekstreme dhe duke këshilluar lartësimin e një fryme që shkon përtej inateve të vjetra që ringjallen. Të tilla janë shkrimet “Trazimet e sotme mes shqiptarësisë dhe grekësisë,”⁶⁹ “Retorika nacionaliste e Spahiut, një abuzim banal në emër të politikës së ditës,”⁷⁰ “Nacionalizmi pa sens,”⁷¹ “Sfidat me pakicat,”⁷² “Mbi (keq)kuptimin dhe (keq)përdorimin e religjionit,”⁷³ etj.

⁶⁵ F. Mejdini, “Spahiu në Kukës: Jo martesave brenda gjinisë, ligj për ndalimin e abortit,” & “Shoqatat: Deklaratat mesjetare, po sakrifikohen të drejtat tona për fushatë,” Shqip, 11 mars, 2013, f.2-3.

⁶⁶ V. Karaj, “A do ta pranojnë partitë flamurin e LGBT-së në fushatë,” Mapo, 6 mars, 2013, f.2.

⁶⁷ O. Mitre, “Romët, kërkesë Bashkisë: Duam memorialin tonë,” Gazeta Shqiptare, 23 shkurt, 2013.

⁶⁸ Standard, 11 mars, 2013, f.10.

⁶⁹ A. Cipa, Shqip, 13 shkurt, 2013, f.8.

⁷⁰ P. Barka, Mapo, 14 shkurt, 2013, f.11.

⁷¹ B. Fevziu, Panorama, 4 shkurt, 2013, f.19.

⁷² I. Totozani, Panorama, 14 shkurt, 2013, f.24.

Po kështu, mjaft gazeta kanë ribotuar edhe disa shkrime të mediave të huaja apo agjencive ballkanike të lajmeve, të cilat pasurojnë pasqyrimin dhe problematikën e trajtuar në media në lidhje me diversitetin, sidomos nga pikëpamja etnike. Dy artikuj bien në sy veçanërisht, të cilat, pavarësisht titujve bombastikë, japin një pamje komplekse dhe të plotë të problemeve që trajtojnë në lidhje me nacionalizmin që po rishfaqet në politikë dhe në fusha të tjera të jetës, si në futboll.⁷⁴

Përfundime

Ky monitorim ishte i kufizuar në numrin e mediave të monitoruara dhe në periudhën e monitorimit. Rrjedhimisht, edhe përfundimet nuk mund të jenë përfaqësuese, por vetëm një vështrim i shkurtër dhe i kufizuar i prirjeve të gjuhës së urrejtjes në median e shkruar. Edhe pse gjuha e urrejtjes nuk mund të thuhet që mbizotëron, ajo gjithsesi është e pranishme. Kjo gjuhë është me tepër e pranishme nëpërmjet ligjërimit të figurave publike, editorialeve, apo intervistave, sesa nëpërmjet raportimit të vetë gazetarëve. Veçanërisht e pranishme është dhuna verbale, kryesisht mes politikanëve, por edhe në formën e kronikës së zezë apo dhe në rubrika të tjera.

Raportimi për çështjet e minoriteteve në Shqipëri dhe për ngjarjet në rajon ku janë të përfshira popullsitë shqiptare është gjithashtu një zonë e minuar ku mund të depërtojë gjuha e urrejtjes. Edhe pse kujdesi në media për të raportuar në këtë fushë ka ardhur në rritje, haset ende pakujdesi dhe tendenciozitet.

Pasqyrimi i stereotipeve dhe klisheve, sidomos në marrëdhëniet etnike dhe ato fetare është i pranishëm, edhe pse i kufizuar. Në këtë periudhë, përdorimi i historisë dhe historianëve për të përjetësuar konfliktet mes grupeve të ndryshme apo dhe mes popujve në Ballkan ka qenë veçanërisht i dukshëm.

Së fundmi, duhet thënë që ka dhe përpjekje serioze, edhe pse të izoluara, për pasqyrimin sa më kompleks dhe të plotë të situatës, sidomos nga disa analistë. Gjithsesi, një qëndrim pro-aktiv nga vetë media në këtë fushë mungon, duke neglizhuar vazhdimisht disa minoritete, si ai rom, në rastin më të dukshëm. Po kështu, mungesa e një filtri vetë-rregullues bën që paragjykimet apo tendenciozitetet të caktuara t'i shpëtojnë rjetës së gjykimit të stafit të gazetave.

⁷³ A. Kelmendi, Standard, 13 mars, 2013, f.10.

⁷⁴ “Më mirë të jesh me ngjyrë se serb,” Standard, 7 shkurt, 2013, f.10 & N. Cabric, “Nacionalistët serbë rikthejnë gjuhën e urrejtjes,” Shqip, 2 shkurt, 2013, f. 18-19.

Gjuha e urrejtjes në mediat shqiptare online

- **Vështrim i përgjithshëm për median online**

Në shoqëritë e sotme moderne, aksesit në internet po artikullohet dhe po sanksionohet jo thjesht si një shërbim i domosdoshëm por si pjesë e të drejtave themelore të njeriut ose e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe të informimit. Një pjesë e vendeve të BE e kanë përfshirë tashmë këtë të drejtë në legjislacionin përkatës.⁷⁵ Në Republikën e Shqipërisë e drejta e aksesit në internet artikullohet në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Aksesit në internet po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një premisë themelore e jetës humane. Dixhitalizimi i shumë prej aktiviteteve të përditshme dhe kryerja e mjaft shërbimeve të domosdoshme përmes internetit, e kanë kthyer këtë medium në një komponent ekzistencial, mungesa e të cilit do të shkaktonte një boshllëk dramatik dhe të paimagjinueshëm për veprimtarinë njerëzore.

Përveç plotësimit të nevojave të njeriut për komunikim të shpejtë dhe modern si dhe përdorimit gjithnjë e më të madh në punën e përditshme, interneti paraqitet edhe si një hipodrom i pamatë i fjalës së lirë. Tek interneti liria e shprehjes ka gjetur një infrastrukturë teknologjike që i shumëfishon hapësirën dhe kapacitetet e kësaj të drejte.

Aksesit i publikut në internet është i ndryshëm si nga ana cilësore edhe nga ana sasiore prej aksesit në mass-mediat tradicionale si shtypi, radio dhe televizioni. Këto të fundit historikisht kanë krijuar shumë pak hapësirë për audiencën që të reagojë apo të ndërveprojë dhe akoma më pak hapësirë që të shprehet përmes tyre. Kurse interneti i jep mundësinë kujtdo që të reagojë dhe të ndërveprojë, të zgjedhë informacionin që i intereson dhe të neglizhojë atë që nuk i intereson. Përmes Web 2.0 individit mund të shkojë edhe më tej, ai mund të krijojë median e vet: një website apo një blog, një kanal në YouTube apo një photostream në Flickr. Në internet publiku është aktiv dhe i pranishëm në të dyja skenat: si në skenën e konsumimit të informacionit, ashtu edhe në atë të prodhimit të tij.⁷⁶

Pothuajse të gjitha kategoritë shoqërore, grupet e interesit si dhe ato të kauzës, janë sot në një farë mënyre të përfaqësuar dhe të pranishëm në internet. Atribute dhe përparësi të webit, siç janë shtrirja globale, pafundësia e informacionit, menjëhershëmëria e komunikimit dhe e përcjelljes së informacionit, karakteri interaktiv, etj. po përdoren gjerësisht dhe pozitivisht nga publiku i gjerë dhe media.

Por këto veçanti dhe përparësi të teknologjisë së internetit, kanë gjithashtu edhe anën e tyre të errët. Kështu liria e aksesit dhe hapësira e gjerë informative në internet, krijon mundësinë që të

⁷⁵ Report - Freedom of Expression on the Internet -A study of legal provisions and practices related to freedom of expression, the free flow of information and media pluralism on the Internet in OSCE participating States”, OSCE, The Office of the Representative on Freedom of the Media, 2010, faqe 10.

⁷⁶ Zguri Rrapo, “Publiku në udhëkryqin media klasike – internet”, Linku: <http://mediapermedian.wordpress.com/2012/11/27/publiku-ne-kryqezimin-media-klasike-internet/>

përfshihen në të çdo lloj kategorie e njerëzve dhe bën që të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në këtë mass-media edhe individë që shpërndajnë mesazhe të intolerancës dhe të urrejtjes së formave të ndryshme. Siç dihet interneti është një super-rrjet kompjuterash të lidhur me një-tjetrin pavarësisht vendit ku ndodhen këta kompjutera dhe pavarësisht nga përdoruesit e tyre. Çdo person ose organizatë që ka një kompjuter të lidhur me internetin mund të publikojë çfarëdo lloj informacioni online. Anonimiteti, i pranishëm gjërësisht në internet, dhe natyra e teknologjisë me porta të hapura luajnë një rol negativ në këtë drejtim.

Natyrisht gjuha e urrejtjes në internet i ka rrënjët në stereotipet dhe paragjykimet që kanë ekzistuar në shoqëri shumë kohë përpara se të lindte interneti. Megjithatë interneti krijoi dhe shtoi një problematikë të caktuar lidhur me gjuhën e urrejtjes. Është fakt se idhtarët e urrejtjes qenë nga të parët që njohën dhe përdorën mundësitë dhe përparësitë që ofronte interneti lidhur me shpërndarjen e informacionit.

Në këtë raport studimor do të fokusohemi tek gjuha e përdorur në mediat kryesore shqiptare online, duke u ndalur më në detaje në rezultatet e monitorimit të tre websiteve të lajmeve: Albeu (<http://www.albeu.com/>), GazetaStart (<http://www.gazetastart.com/>) dhe Lajmi i Fundit (<http://www.lajmifundit.al>).

- **Panoramë e përgjithshme për gjuhën e përdorur në mediat shqiptare online**

Burimet kryesore të lajmeve në hapësirën shqiptare online janë websitet e gazetave dhe të televizioneve kryesore, disa portale lajmesh të krijuara gjithashtu nga kompanitë e mediave tradicionale si dhe websitet individuale që nuk lidhen me ndonjë media klasike por që janë produkte autentike webi. Gjatë viteve të fundit një kanal i rëndësishëm informimi po bëhen edhe rrjetet sociale dhe blogosfera. Por këto të fundit nuk janë përfshirë në këtë studim, për arsye të specifikave të cilat diktojnë një studim të veçantë të tyre.

Problematika e etikës dhe e gjuhës së urrejtjes në websitet shqiptare të lajmeve është e gjerë dhe e larmishme. Rastet më të shumta lidhen me paragjykimet dhe urrejtjen që ka për bazë përkatësinë, orientimin apo bindjet politike të tjetrit.

Pothuajse gjatë gjithë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, konflikti më i mprehtë në shoqërinë shqiptare ka qënë konflikti politik. Forcat politike përdorin shpesh gjuhë të dhunshme dhe me ngarkesë urrejtjeje ndaj kundërshtarëve politikë dhe klima armiqësore politike ka influencuar të gjithë piramidën e shoqërisë, dhe në një masë të madhe edhe mediat në vend. Analisti Remzi Lani vë në dukje se “është fakt i pashmangshëm që një shoqëri e ngarkuar me konflikte dhe tejet e politizuar (çka vazhdon të jetë e vertetë për shoqëritë e Ballkanit) e infekton median e saj dhe e tërheq në konflikte e luftra, madje e përdor si një mjet të rëndësishëm për zhvillimin e këtyre

konflikteve, duke shkatërruar kështu pavarësinë, paanshmërinë dhe profesionalizmin e saj gjatë këtij procesi.”⁷⁷

Por përveç gjuhës së urrejtjes politike, nuk mungojnë edhe shkrimet e gazetarëve apo komentet e lexuesve ku janë të pranishme stereotipet dhe paragjykimet për shkak të përkatësisë etnike, fetare, racore, gjinore, seksuale dhe madje edhe krahinore apo sociale.

Gjatë monitorimeve të mediave shqiptare online (nga viti 2009 deri më sot) për nevoja të projekteve dhe të programeve të ndryshme të trajnimit të organizuara nga Instituti i Medias apo nga Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit i Universitetit të Tiranës janë vërejtur disa tipare kryesore të gjuhës së urrejtjes në median online. Në këtë seksion do të përshkruhen disa nga rastet më tipike, duke iu përmbajtur parimit metodologjik që kur rastet vijnë nga website me audiencë të papërfillshme, emri dhe URL-ja e tyre nuk do të përmendet, për të mos gjeneruar mundësi audience për website jo serioze, ndërsa kur rastet vijnë nga website me audiencë të madhe emri dhe URL-ja e tyre do të përmendet.

Pas gjuhës së urrejtjes politike, në hapësirën shqiptare online përdorimin më të madh e ka gjuha negative me bazë stereotipet apo paragjykimet etnike. Nga kjo gjuhë nuk kanë shpëtuar edhe website të mediave të mëdha dhe serioze. Kështu në një intervistë me një sportist të njohur të lindur në Himarë por që jeton në Greqi të botuar në janar të vitit 2012, gazetari insiston në pyetjet e veta që sportisti të deklarojë nëse është e vërtetë të ketë thënë që “fëmijët e tij kanë gjak shqiptari” dhe, pasi merr përgjigjen “unë jam grek” nga i intervistuari, e vendos këtë përgjigje në titull të shkrimit.⁷⁸ Aksi kryesor i intervistës sillet rrotull deklarimit të origjinës etnike të të intervistuarit, pavarësisht se ky lloj deklarimi nuk ka pse të ketë vlerë dhe rëndësi publike, por është thjesht një e drejtë e individit. Në një rast të tillë kemi të bëjmë me përmendjen pa vend të origjinës etnike të tjetrit me qëllim ose nëntekst diskretitimi, një stereotip ky i cili shfaqet që në titullin e shkrimit. Jo rastësisht në shumë komente të lexuesve për këtë intervistë, artikullohet një gjuhë denigruese me bazë etnike, e cila është gjeneruar dhe nxitur pikërisht nga drejtimi që i është dhënë intervistës si dhe nga stereotipet që e kanë udhëhequr atë.

Në një website tjetër periferik, është botuar shkrimi me titull “T’i thuhet ndal uzurpimit të pushtetit politik nga vllahët në Shqipëri”. Autori, duke spekuluar me origjinën etnike të individëve, përpiqet të argumentojë se një pjesë e personazheve kryesore të politikës dhe të administratës shtetërore janë me origjinë vllahe, dhe pikërisht për arsye të origjinës së tyre ata nuk duhet të jenë në këto poste apo pozita politike. Autori i shkrimit në logjikën e tij shkon kundër të drejtës kushtetuese të çdo shtetasi të Republikës së Shqipërisë që të zgjidhet apo të emërohet në çdo lloj posti pavarësisht nga origjina e tij etnike. Shkrimi nxit dhe motivon në mënyrë të drejtpërdrejtë paragjykimet dhe stereotipet ndaj një prej minoriteteve etno-kulturore në vend, me të cilin shumica e popullsisë ka patur historikisht marrëdhënie të njohura të pranimit, mirëkuptimit dhe të tolerancës.

⁷⁷ Lani Remzi, “Media e Ballkanit, lost in transition”, MediaLink 1, <http://www.institutemedia.org/balkan-r-lani.html>

⁷⁸ Linku: <http://www.balkanweb.com/intervista/2688/pirro-dhima-jam-grek-biseda-me-jorgo-goron-78801.html>

Probleme të tjera që ndeshen në raportimet apo komentet online dhe që lidhen me gjuhën negative apo paragjykimet ndëretnike janë edhe përdorimi i argumentit nacionalist në shërbim të argumentit politik, lidhja me etninë e një komuniteti i çdo lloj zhvillimi që ndodh në këtë komunitet, portretizimi kolektiv në vend të atij të grupit apo atij individual (francezët bëjnë kështu, grekët janë të tillë, etj.), përmendja si argument e raporteve dhe përqindjeve etnike në strukturën e popullsisë (loja me shifrat për numrin e minoriteteve), trajtimi i subjektit me karakter nacionalist njëlloj si sensacionet e kronikës së zezë apo si skooptet e politikës, mungesa e njohurive të një pjese të reporterëve, mungesa e reporterëve të specializuar për çështjet ndëretnike, mungesa e respektit kortezial për liderët e etnive të tjera, përdorimi i një proze me ngarkesë të dukshme të emocioneve negative, etj.

Edhe stereotipet dhe paragjykimet racore nuk mungojnë, por prania e tyre në hapësirën e mediave shqiptare online është tepër sporadike dhe në website tepër periferike si dhe kryesisht në komentet nga audienca. Kështu një shkrim i kryetarit të shoqatës ballkano-egjiptiane “Nefreta” me titull “Ballkano-egjiptianët duhet të thonë fjalën e tyre” i botuar në gazetën “Koha Jonë”, është ribotuar edhe nga një website periferik në 29 janar të vitit 2010, dhe në komentet për këtë shkrim në këtë website është lejuar një gjuhë e pastër raciste ndaj komunitetit me ngjyrë në Shqipëri nga një komentues i shkrimit. Me sa duket shkrimi është zgjedhur për t’u botuar pikërisht për të krijuar hapësirë për këto lloj komentesh.

Një problematikë e pranishme në websitet shqiptare të lajmeve është edhe ajo që ka të bëjë me gjuhën e papërshtatshme dhe paragjykimet me bazë fetare. Në Shqipëri ekzistojnë katër komunitete fetare kryesore: muslimanët, bektashinjtë, të krishterët ortodoksë dhe katolikët. Në vend historikisht kanë ekzistuar marrëdhënie ndërjetare të mbizotëruara nga toleranca dhe mirëkuptimi. Por interneti, duke qënë një medium i të gjithëve ka krijuar hapësirë edhe për individë që kanë bindje apo qëllime ekstremiste apo fundamentaliste fetare. Raste të rënda të pranisë së gjuhës së ekstremizmit dhe fundamentalizmit në këtë fushë janë shfaqur sidomos në faqet apo forumet e disa websiteve me numër të paktë vizitorësh, por që ekzistojnë prej vitesh në internet.

Kështu në një shkrim me titull “Katolikët e Berishës”⁷⁹ të botuar në një website periferik autori “shqetësohet” për pushtetin e tepruar dhe numrin e madh të drejtuesve me origjinë katolike në Partinë Demokratike. Në qendër të shkrimit, si ilustrim edhe i stereotipeve apo i qëllimeve të autorit, botohet edhe karikatura e një dordoleci në formën e kryqit, siç e shihni më poshtë.

⁷⁹ Aksesuar më 13 janar 2011.

"Katolikët e Berishës"

07. 10. 2010 nga *Kritika*

Si përfaqësuese e Shqipërisë në sallën e Parlamentit Europian, për debatin përfundimtar për vizat, është vetëm zonja Topalli. Një imazh i sforcuar katolik, i një vendi me shumicë myslimane, që Berisha po përpiqet me shumë kujdes t'ja paraqesë një Europë me shumicë katolike.

Zonja Topalli është katolikja e dytë, pas të ndjerit Pjetër Arbnori, që Berisha e ka vënë në krye të Parlamentit. Por a mjafton kjo për të hyrë në Europë?

Në fillim të viteve '90, kur Sali Berisha (më shumë një komunist konservator - se një mysliman i tillë) u seleksionua (nuk dihet nga kush) prej një tufe konkurrentësh të krishterë, të drejtonte PD-n, ndoshta nuk e kishte menduar se ky fakt do ia vështirësonte shumë rrugën



Shakaja e ditës

- E patë Berishën me triumf e trajtoi liberal e vizave. Komplet në ekstazë. Sikur ai e b Kësaj i thonë: Oj Eu kurva e motit, ç'na e n'kurriz, kët kriç Skra

Komentet e faqes

- SHUPLAKES
2 ditë 31 min më pa
- Kujt na i ardhka keq "fyrjet" ndaj Metes?
2 ditë 36 min më pa
- Ilir Meta, debil a kopi
3 ditë 1 orë më parë
- cfare shenje horosk

Natyrisht postime të tilla në hapësirën shqiptare online janë të rralla, por gjithsesi ato ekzistojnë në skuta të largëta të internetit dhe meqë vazhdojnë prej vitesh të jenë të pranishme, mund të shpresojnë që dikur të rrisin audiencën e tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që të propozohen zgjidhje ligjore apo etike edhe për raste të tilla.

Në raportimet dhe komentet online gjenden gjithashtu edhe stereotype dhe paragjykime për shkak të përkatësisë gjinore apo seksuale. Në një shkrim me titull “Femrat drejtuese ??? Më të këqija se meshkujt”⁸⁰, autori përpiqet të citojë edhe psikologë për të provuar tezën e tij se femrat “kur vjen fjala për të drejtuar një vend pune me shumë vartës janë më të këqija se vetë meshkujt” për shkak se tek femrat “ekziston gjithmonë një lloj pakti me të keqen”.

Ndërsa në një intervistë tjetër me titull “Homoseksualët, drejtues në politikë, drejtësi e media”⁸¹ të botuar në website-in e gazetës Shekulli, drejtuesit e politikës, drejtësisë dhe të medias, klasifikohen edhe sipas orientimit të tyre seksual.

⁸⁰ Aksesuar më 24 tetor 2011

⁸¹ www.shekulli.com.al, Aksesuar më 4 prill 2010

- **Raport për tre website të monitoruara: Albeu, GazetaStart dhe Lajmi i fundit**

Tre websitet e monitoruara: Albeu (<http://www.albeu.com/>), GazetaStart (<http://www.gazetastart.com/>) dhe Lajmi i Fundit (<http://www.lajmifundit.al>) janë ndër websitet individuale më të njohura në vend që renditen gjithashtu në listën e websiteve më të klikuara nga audienca shqiptare e lajmit online. Websitet janë monitoruar në një periudhë 2 mujore prej datës 1 shkurt 2013 deri më datën 31 mars 2013.

Që të tre këto website nuk janë krijuar nga kompanitë e mediave tradicionale por nga individë të pasionuar pas mediave të reja dhe lajmit online. Ato operojnë si biznese të lajmit online për një periudhë nga katër deri në dhjetë vjet dhe, duke rritur audiencën, kanë shtuar edhe të ardhurat e tyre me të cilat kanë siguruar mbijetesën në një treg të vështirë siç është ai i informacionit online.

Metodologjia e përdorur ka qënë monitorimi i informacionit sipas rubrikave apo kategorive, duke e kryer këtë monitorimin 24 deri në 48 orë pas ditës së botimit, për të krijuar mundësinë që në monitorim të përfshihen edhe komentet e lexuesve të cilat zakonisht gjenerohen nga një deri në dy ditë pas botimit të një shkrimi. Lënda e monitoruar ka përfshirë çdo lloj shkrimi apo informacioni të botuar, pa bërë asnjë lloj përjashtimi. Në monitorim janë përfshirë edhe komentet si dhe komentet mbi komentet, sipas kronologjisë së publikimit të tyre, duke i konsideruar ato si pjesë e lëndës së botuar në website, për botimin e të cilave redaksitë përkatëse kanë përgjegjësinë e tyre etike dhe editoriale.

Në një vlerësim të përgjithshëm mund të themi se në të tre këto website tregohet një kujdes i konsiderueshm për të evituar sa më shumë që të jetë e mundur shkeljet e etikës dhe përdorimin e gjuhës së rëndë dhe të papërshtatshme. Në këtë pikë ato mund të vlerësohen si më korrekte dhe më të vëmendshme se sa websitet e gazetave apo të televizioneve më të mëdha në vend. Kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se këto website “dalohen për një raportim më të distancuar dhe më të balancuar krahasuar me websitet e mediave tradicionale. Ato paraqiten si të ndikuara më pak nga politika dhe nga interesat ekonomike apo interesa të tjera”.⁸²

Në praktikën editoriale vihet re një shkallë më e lartë përgjegjshmërie dhe një nivel i kënaqshëm vetërregullimi. Edhe pse nuk kanë një kod etike të plotë të publikuar në faqet e tyre, ato aplikojnë shënimet redaksionale dhe tërheqjen e vëmendjes së vizitorëve për të respektuar normat e etikës dhe për të mos keqpërdorur lirinë e shprehjes, siç ndodh në rastin e Gazeta Start.

⁸² Zguri Rrapo, “Mediat online në Shqipëri – një vështrim panoramik”, Linku: <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/rr-zguri-follow-up.pdf>

Por megjithë këtë kujdes duhet thënë se nga monitorimi rezulton se nuk mungojnë rastet e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme apo me ngarkesë urrejtjeje, më së shumti si rezultat i mungesës së burimeve njerëzore të angazhuara për moderimin e komenteve të lexuesve por edhe për shkak të mosnjohjes apo mos-aplikimit nga gazetarët të disa normave etike që do të mund të shmangnin publikimin e shkrimeve apo komenteve me probleme të tilla.

Më poshtë po paraqesim rezultatet e monitorimit dhe analizën e tyre për çdo website më vete:

❖ Lajmi i Fundit

URL: <http://www.lajmifundit.al>

Lajmi i Fundit është themeluar vetëm katër vjet më parë, në vitin 2009, por në një kohë të shkurtër ky website lajmesh ka arritur të bëhet një nga websitet më të vizituara të hapësirës shqiptare online. Sipas motorit statistikor Alexa, **lajmifundit.al** renditet i 26-ti në top-listën e 100 websiteve më të klikuara në Shqipëri.⁸³ Ndërkohë sipas **trafficestimate.com** për muajt shkurt dhe mars 2013, lajmi i fundit ka patur një mesatare prej rreth 392000 vizitash në muaj.⁸⁴

Nga monitorimi i kryer rezulton se rastet më të shumta të cënimit të etikës dhe të përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe me ngarkesë urrejtjeje tek website-i Lajmi i Fundit, i takojnë kategorisë “Politika”, në të cilën numërohen 37 shkrime me probleme të kësaj natyre, nga totali prej rreth 620 shkrimesh të botuara në këtë kategori gjatë periudhës dymujore të monitorimit. Nga këto, në 21 shkrime problemet konstatohen tek komentet e lexuesve, kurse në 11 prej tyre problemet konstatohen në titullin e shkrimeve, në tekstin e shkrimit apo në citimet dhe perifrazimet e personazheve të ndryshëm të politikës. Më tej, në rubrikën “Aktualitet” numërohen 9 shkrime me probleme etike të përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe me ngarkesë urrejtjeje, prej të cilave 5 shkrime kanë probleme në komentet e tyre kurse 4 shkrime kanë probleme në titullin e shkrimeve, në tekstin e shkrimit apo në citimet dhe perifrazimet e bëra. Në kategorinë “Kultura” numërohen 3 shkrime me probleme të tilla, në kategorinë “Ekonomia” 3 shkrime, në kategorinë “Bota” 1 shkrim dhe në kategorinë “Kosova” 1 shkrim.

Siç duket qartë nga këto shifra, numri më i madh i shkrimeve problematike i takon kategorisë së politikës. Siç e theksuam edhe më sipër, gjuha e urrejtjes politike është ajo që ndeshet më shpesh jo vetëm në këtë website, por edhe në të gjitha websitet e tjera të lajmit shqip online. Kjo shpjegohet me shkallën e lartë të konfliktualitetit në politikën shqiptare, me gjuhën e rëndë, të vrazhdë dhe me ngarkesë urrejtjeje të përdorur nga lidershipi politik i vendit, gjuhë, e cila, përmes shkrimeve, perifrazimeve, citimeve apo komenteve ka depërtuar edhe në mediat online.

⁸³ <http://www.alexa.com/topsites/countries/AL>, Aksesuar më 14 maj 2013

⁸⁴ <http://www.trafficestimate.com/www.lajmifundit.al>, Aksesuar më 28 shkurt 2013 dhe 31 mars 2013

Në këtë rast çështja shtrohet se cili është qëndrimi editorial që duhet të mbajë redaksia në rastet e deklaratave, fjalimeve apo ligjëratave të politikanëve të cilat bartin gjuhë urrejtjeje politike. A duhet botuar gjithçka e plotë, siç është thënë apo shkruar prej tyre apo duhet mbajtur një qëndrim redaksional më selektiv dhe më përjashtues për këtë lloj gjuhe? Natyrisht përvoja më e mirë tregon se të qenit selektiv duhet aplikuar doemos edhe për ligjërimin politik të papërshtatshën dhe që gjeneron konfliktualitet dhe urrejtje në publik.

Të cilit lloj dhe të ç'natyre janë problemet e hasura tek Lajmi i Fundit? Nga monitorimi rezulton se përdorimin më të madh e ka gjuha e ulët, denigruese, fyese dhe sulmet personale ndaj kundështarëve politikë apo ndaj liderëve të kampeve politike në vend. Është fakt se më së shumti kjo gjuhë është përdorur në komentet e lexuesve, por ne po e përfshijmë në analizën tonë edhe gjuhën e komenteve, duke qënë se se ato janë të pranishme në hapësirën e publikimit të website-it dhe publikimi ose jo i tyre është (ose duhet të jetë patjetër) komponent i politikës redaksionale.

Gjuha e ulët, denigruese, fyese dhe sulmet personale ndaj personazheve të politikës apo ndaj liderëve të kampeve politike në vend ndeshen në artikujt e mëposhtëm:

– “Rama publikon pikturën ku tregon PD-në duke vjedhur popullin”, botuar në datën 4 shkurt 2013⁸⁵

– “Rama: Kush do çlirimin e drejtësisë ta grushtojë me votë këtë pushtet të kalbur”, botuar në datën 8 shkurt 2013⁸⁶

– “Brace: Selamin Berisha e rrahu dhe e përzuri nga Shqipëria, tani kryeson listën e Beratit”, botuar në datën 13 shkurt 2013⁸⁷

– “PS konfirmon zyrtarisht: Rama pësoi luhatje tensoni, mori serum në Burrel”, botuar në datën 13 shkurt 2013⁸⁸

– “Rama: Grabitësit e mandatit nuk do mund ta rrënojnë dot Tiranën”, botuar në datën 15 shkurt 2013⁸⁹

– “Spahiu në SHBA: Në Shqipëri nuk garantohen dot zgjedhjet e lira”, botuar në datën 17 shkurt 2013⁹⁰

– “Zgjedhjet e 23 qershorit: Rama prezanton kandidat për deputet të Kavajës, Parid Carën..”, botuar në datën 17 shkurt 2013⁹¹

⁸⁵ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/04/rama-publikon-pikturen-ku-tregon-pd-ne-duke-vjedhur-popullin/>

⁸⁶ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/08/rama-kush-do-clirimin-e-drejtjesise-ta-grushtoje-me-vote-kete-pushtet-te-kalbur/>

⁸⁷ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/13/brace-selamin-berisha-e-rrahu-dhe-perzuri-nga-shqiperia-tani-kryeson-listen-e-beratit/>

⁸⁸ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/13/ps-konfirmon-zyrtarisht-rama-pesoi-luhatje-tensiononi-mori-serum-ne-burrel/>

⁸⁹ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/15/rama-grabitesit-e-mandatit-nuk-do-mund-ta-rrenojne-dot-tiranen/>

⁹⁰ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/17/spahiu-ne-shba-ne-shqiperi-nuk-garantohen-dot-zgjedhjet-e-lira/>

⁹¹ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/17/zgjedhjet-e-23-qershorit-rama-prezanton-kandidatin-per-deputet-te-kavajes-parid-cara/>

–“PD, Vorpsi: Heshtja e Edi Ramës na jep të drejtë ta akuzojmë për pastrim parash”, botuar në datën 19 shkurt 2013⁹²

–“Rama: Edhe sa jetë policësh do të kushtojë tradhtia e pushtetit ndaj policisë?”, botuar në datën 24 shkurt 2013⁹³

–“Brace: Berishës i kanë dalë vrasësit jashtë kontrollit, pushteti aleancë me krimin”, botuar në datën 25 shkurt 2013⁹⁴

–“Rama: Berisha i bën opozitën opozitës, hesht për vrasjet e kryekomisarëve”, botuar në datën 26 shkurt 2013⁹⁵

–“Berisha: Doni t’ua them se si u rrëzua Fatos Nano? Komploti i Ramës i filmuar”, botuar në datën 4 mars 2013⁹⁶

–“Topalli: Të ishte për mua, biznesmenët dhe miliarderët nuk futen në Parlament”, botuar në datën 5 mars 2013⁹⁷

–“Beqja: Berisha hajdut që vjedh xhepat e shqiptarëve dhe programin e PS”, botuar në datën 6 mars 2013⁹⁸

–“Berisha: Nuk tërhiqem për referendumin, në pranverë zgjedhjet më të qytetëruara”, botuar në datën 7 mars 2013⁹⁹

–“Braçe Berishës: Nxore në pritë Azemin, vrave një fis të tërë në Tropojë, zhduke Remzi Hoxhën” botuar në datën 7 mars 2013¹⁰⁰

–“Rama: Berisha mohon 1 milion të papunë, po rrënon shtresën e mesme”, botuar në datën 9 mars 2013¹⁰¹

–“AK, Spahiu: Vendi të shkojë në qeveri teknike, ministrat kanë lënë zyrat”, botuar në datën 13 mars 2013¹⁰²

–“Olldashi: 28 të zgjedhur të PS kanë ndryshuar emrat, kanë dosje jashtë shtetit”, botuar në datën 14 mars 2013¹⁰³

⁹² <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/19/pd-vorpsi-heshtja-e-edi-rames-na-jep-te-drejte-ta-akuzojme-per-pastrim-parash/>

⁹³ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/24/rama-edhe-sa-jete-policesh-do-kushtoje-tradhtia-e-pushtetit-ndaj-policise/>

⁹⁴ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/25/brace-berishes-i-kane-dale-vrasesit-jashte-kontrollit-pushteti-aleance-me-krimin/>

⁹⁵ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/02/26/rama-berisha-i-ben-opoziten-opozites-hesht-per-vrasjet-e-kryekomisareve/>

⁹⁶ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/04/berisha-opozites-doni-tua-them-se-si-u-rrzua-fatos-nano-komploti-i-rames-i-filmuar/>

⁹⁷ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/05/topalli-te-ishte-per-mua-biznesmenet-dhe-miliarderet-nuk-futen-ne-parlament/>

⁹⁸ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/06/beqja-berisha-hajdut-qe-vjedh-xhepat-e-shqiptareve-dhe-programin-e-ps/>

⁹⁹ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/07/berisha-nuk-terhiqem-per-referendumin-ne-pranvere-zgjedhjet-me-te-qytetaruara/>

¹⁰⁰ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/07/brace-berishes-nxore-ne-prite-azemin-vrave-nje-fis-te-tere-ne-tropoje-zhduke-remzi-hoxhen/>

¹⁰¹ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/09/rama-berisha-mohon-1-milion-te-papune-po-rrenon-shtresen-e-mesme/>

¹⁰² <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/13/ak-spahiu-vendi-te-shkoje-ne-qeveri-teknike-ministrat-kane-lene-zyrat/>

–“PS, Tahiri: Nis numërimi mbrapsht i 100 ditëve të Berishës. Drejtësi për Gërdecin” ”botuar në datën 16 mars 2013¹⁰⁴

– “Bamir Topi: Pushteti ka marrë tiparet e monizmit me një kryeministër diktator”, botuar në datën 20 mars 2013¹⁰⁵

– “AK: Pashaj, Berisha dashnor i fjalës së burgosur dhe të pushtuar”, botuar në datën 23 mars 2013¹⁰⁶

Nuk është e vështirë të konstatohet tek këto shkrime që në titull gjuha e urrejtjes politike, akuzat e rënda të politikanëve për njëri-tjetrin, fjalori i vrazhdë dhe sulmet personale. Siç shihet kjo gjuhë më së shumti është e perifrazuar apo e cituar nga gjuha e politikanëve. Por kjo nuk mund të shmangë përgjegjësinë editoriale për të vendosur tituj më neutralë dhe pa këtë ngarkesë negative dhe për të filtruar apo shmangur dhunën verbale si dhe botimin e fyerjeve dhe të sulmeve personale të politikanëve. Pikërisht në artikuj të tillë problematikë, komentet e lexuesve ndjekin të njëjtën linjë me gjuhën e politikanëve, duke qënë madje edhe më të rënda dhe me ngarkesë urrejtjeje më të madhe.

Zgjidhja në këtë rast do të ishte filtrimi së pari i gjuhës së politikanëve të cituar në titull apo në tekst dhe më tej edhe filtrimi i kujdesshëm i komenteve të lexuesve, filtrim i cili në shkrimet e mësipërme pothuajse mungon. Media i drejtohet një publiku më të gjërë se sa publiku i politikanëve në foltoret e tyre, për këtë arsye përgjegjësia e tyre është e madhe, qoftë edhe kur citohen personazhe të politikës. Në ndërmjetësimin e saj mes politikanëve dhe publikut, media duhet të kryejë një funksion amortizues dhe zbutës të gjuhës së urrejtjes politike dhe jo të bëjë amplifikimin e saj.

Në ligjërimin politik të cituar në disa shkrime të tjera, gjejmë edhe raste kur argumenti etnik thirret në ndihmë të argumentit politik. Rritja e toneve nacionaliste në politikën shqiptare është një dukuri e dy viteve të fundit, sidomos pas daljes në skenë të partisë Aleanca Kuqezi. Nën ndikimin e politikës, tonet e larta nacionaliste janë përcjellë në një farë mase edhe në media dhe në publikun e saj. Në disa shkrime ku raportohet për veprimtari të partisë Aleanca Kuqezi, citohen që në titull deklarata të bëra nga kryetari i kësaj partie, të cilat provokojnë ndjeshmëritë etnike, si p.sh. në shkrimet: “AK: Shteti shqiptar të arrestojë Dulen dhe Kserën, financojnë Agimin e Artë”, “AK në Korçë: Spahiu, gërmimet për varrezat greke - cënim i dinjitetit”. Në një shkrim tjetër me titull “Korçë, Omonia feston 22 vjetorin me himnin grek, krenare për

¹⁰³ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/14/olldashi-28-te-zgjedhur-te-ps-kane-ndryshuar-emrat-kane-dosje-jashte-vendit/>

¹⁰⁴ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/15/ps-tahiri-nis-numerimi-mbrapsht-i-100-diteve-te-berishes-drejttesi-per-gerdecin/>

¹⁰⁵ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/20/topi-pushteti-ka-marre-tiparet-e-monizimit-me-nje-kryeminister-diktator/>

¹⁰⁶ <http://www.lajmifundit.al/lajme/2013/03/23/ak-pashaj-berisha-nje-dashnor-i-fjales-se-burgosur-dhe-te-pushtuar/>

Janullatosin”, shfaqet një gjuhë paragjykuese ndaj simboleve kombëtare të etnive të tjera. Gjithashtu në shkrim shfaqet një mungesë e respektit kortezial për Kryepeshkopin e Kishës Ortodokse Anastasios, i cili thirret me mbiemrin e tij, duke cënuar kështu etikën e kërkuar në këto raste nga media. Ndërsa në shkrimin me titull ““Epiri i Veriut” feston 99 vjetorin. Pirro Dhima: Jam grek”, deklarimi i origjinës etnike nga sportisti i njohur përmendet që në titull me një lloj nënteksti kontestues, edhe pse ky deklarim normalisht s’ka përse të përbëjë lajm. Kjo vjen si rrjedhojë e ndikimit të stereotipeve sipas të cilave përkatësia etnike e bën dikë më inferior apo më superior se tjetri.

Paragjykimet dhe stereotipet me bazë etnike shfaqen edhe në rastet kur gjatë raportimit përmendet origjina etnike e të arrestuarve apo të akuzuarve për krime të ndryshme, pavarësisht se është e njohur se krimi në vetvete nuk ka atdhe apo etni. Gjithsesi një dukuri e tillë duhet thënë se ndeshet shumë rrallë, dhe në rastin e Lajmit i Fundit vetëm në një shkrim, pikërisht në atë me titull: “Tre serbë arrestohen për abuzim seksual”.

Gjatë citimit të personazheve të ndryshme publike nuk mungojnë edhe rastet e paragjykitimit apo të përpjekjes për të diskretituar tjetrin duke sjellë si argument orientimin e tij seksual. Një lloj paragjykimi i tillë vihet re në shkrimet “Qetsori i BB; Elena sipas meje është biseksuale”, dhe “Arber Zeka: Elona ne BB më duket lesbike”. Në të dyja rastet përmendja e orientimit seksual vjen në kontekstin e përpjekjes për ta diskretituar apo denigruar personin në fjalë.

Edhe imazhet e dhunës fizike që përcillen përmes tekstit apo titujve, mund të konsiderohen si derivate apo pararendëse të gjuhës së urrejtjes. Dhuna dhe urrejtja janë në marrëdhënie simbiotike me njëra-tjetër, kështu që kujdesi për shmangjen e tyre duhet ushtruar në të dyja rastet. Si shembull i përdorimit të gjuhës që përcjell imazhe dhune mund të përmenden shkrimet me titull: “Francë: Nëna u pret fytyrën dy fëmijëve dhe zhduket” i botuar në rubrikën “Bota”, si dhe shkrimet “Fotoja e nuses që vrau vjerrën me vaj të nxehtë në vesh” dhe “Fier, vrasësi i dyfishtë në Kuçovë i preu fytyrën vetes në prani të policisë”, të botuara në rubrikën “Aktualitet”.

❖ Gazeta Start

URL: <http://www.gazetastart.com/>

Gazeta Start është një nga iniciativat interesante të websiteve individuale të lajmeve në Shqipëri, që gëzon akses të lartë sidomos në radhët e profesionistëve të rinj të medias online dhe studentëve të gazetarisë, me të cilët kjo media ka patur një lidhje të afërt dhe një bashkëpunim të frytshëm. Website-i dallohet për një raportim serioz dhe përgjithësisht të balancuar.

Krijuar në vitin 2006, Gazeta Start ka arritur të mbijetojë dhe të renditet në vendin e 115-të në listën e websiteve më të klikuara në Shqipëri.¹⁰⁷ Për muajt shkurt dhe mars 2013, ky website ka patur një numër vizitash prej rreth 198000 deri në 200000 në muaj.¹⁰⁸

Gjatë monitorimit të kryer nga data 1 shkurt 2013 deri në 31 mars 2013 është konstatuar një kujdes i konsiderueshëm për shmangien e gjuhës së urrejtjes dhe të cënimeve të etikës në përgjithësi. Redaksia tregon kujdes për filtrimin e komenteve që nuk merren me idetë e paraqitura në shkrime por përdorin gjuhë fyese apo denigruese ndaj autorëve të shkrimeve, ndaj gazetarëve në përgjithësi apo ndaj personazheve të përmendura në shkrime. Ja çfarë shkruhet në një shkrim redaksional të botuar në 13 shkurt 2013, lidhur me këtë çështje:

“Krahas lajmeve, një pjesë e rëndësishme ... janë edhe komentet e lexuesve, që në shumë raste zgjedhin fyerjen dhe denigrimin ndaj opinionistëve ose gazetarëve që shkruajnë artikujt, duke mos pasur kurrfarë lidhje me temën. Publikimi i mesazheve të tilla shpesh krijon kureshtje dhe nxit reagime të shumta, çka mund të çojnë në rritjen e klikimeve. Për t’ia arritur kësaj, madje edhe gazeta të mëdha të përditshme lejojnë dhe nxisin publikimin e komenteve që kanë përmbajtje fyese jo vetëm ndaj një partie të caktuar politike, por edhe ndaj personave konkretë.

Ndryshe nga shumë të tjera, “Gazeta Start” i ka vënë kufi që në fillim këtij fenomeni aspak etik, që cënon jo autorin e një artikulli, por edhe ndihmon në krijimin e një kulture “rruge”, pa kurrfarë vlere. Ndaj, ne që prej fillimit kemi zgjedhur që të mos lejojmë në asnjë rast dhe për asnjë arsye, asnjë koment që nuk ka përmbajtje me temën dhe që shkel parimet morale.”¹⁰⁹

Në seksionin e komenteve, redaksia ka vendosur këtë shënim: **“Sqarim:** Njoftojmë të gjithë lexuesit tanë se komentet të cilat përmbajnë fjalor ofendues, antikombëtar, antifetar, përçarës **NUK DO TË PUBLIKOHEN!!!”**

Megjithatë gjatë monitorimit janë ndeshur edhe raste kur gjuha e papërshtatshme dhe negative i ka shpëtuar filtrit redaksional. Këto raste janë në një numër të vogël dhe në një raport ta pakrahasueshëm me websitet e shumë mediave të njohura në vend, në të cilat ky numër rastesh mund të konstatohet edhe brenda 2-3 ditësh.

Ashtu si edhe tek Lajmi i Fundit, numri më i madh i shkrimeve apo komenteve ku ndeshet gjuhë me ngarkesë urrejtjeje apo e pafiltruar i takon kategorisë “Politika”, me 11 shkrime gjatë dy muajve. Më tej vijon kategoria “Aktualitet” me 5 shkrime, “Rajon” me 5 shkrime dhe “Bota” dhe “Ekskluzive” me nga 1 shkrim. Theksojmë se problematika më e rëndë gjendet tek komentet si dhe dhe tek citimet e politikanëve apo të zëdhënësve të partive politike.

¹⁰⁷ <http://www.alexa.com/topsites/countries/AL>, Aksesuar më 14 maj 2013

¹⁰⁸ <http://www.trafficestimate.com/www.gazetastart.com/>, Aksesuar më 28 shkurt 2013 dhe 31 mars 2013

¹⁰⁹ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7013&cat=8>

Në shkrimet me titull: “23 qershori do ta kthelloje Ramën; reagon kreu i PS”¹¹⁰, dhe “Gjykata e Tiranës dënon deputetin Tahiri”¹¹¹, botuar përkatësisht në 10 dhe 14 shkurt, tek komentet e lexuesve konstatohet një gjuhë urrejtjeje “in ekstremis” ndaj liderëve politikë apo personazheve të njohura të politikës që arrin deri atje sa kërkohet që ata “duhen pushkatuar ...duhet te ikin per ne sibir te ruis e atje duhet te punsohen ne ndonji minier atomike e te vdesin ngadal...“.

Në shkrimet ““Skeçi” i PD-së për konventën e socialistëve”¹¹², “Berisha: Rama shkelmon integrimin, do të firmos për referendumin”¹¹³, “PD: Jetojmë në Shqipërinë e lirë, jo në Shqipërinë e gënjeshtër të Partisë së re “Rama”!”¹¹⁴, dhe “Fidel Ylli pastroi para dhe i fshehu të ardhurat shtetit”¹¹⁵, gjuha e urrejtjes dhe sulmet personale ndeshen në citimet që iu bëhen në shkrim deklarativ të liderëve të politikës apo të zëdhënësve të forcave politike, duke mos bërë filtrimin e gjuhës së përdorur edhe për këto lloj burimesh të informacionit.

Ndërsa në komentin e një lexuesi për shkrimin me titull ““Bulku: Rama i njohur për mungesën e dashurisë ndaj grave”¹¹⁶, konstatohet një gjuhë paragjyquese dhe denigruese ndaj femrave që bëjnë karrierë në politikë apo art.

Sërish në citimet që vijnë nga ligjërimi politik, hasen edhe raste të gjuhës që nxit paragjykimet dhe urrejtjen ndëretnike. Kështu në shkrimin “AK vendos flamurin nazist në dyert e Ministrisë së punës”¹¹⁷, citohen apo perifrazohen të plota disa fragmente të fjalës së liderit të partisë nacionaliste Aleanca Kuqezi, në të cilën konstatohet një gjuhë me ngarkesë të theksuar urrejtje politike dhe ndëretnike. Lideri i cituar kërkon që një ministër i qeverisë shqiptare me origjinë greke të shpallet “trathtar i kombit shqiptar”. E njëjta sintaksë haset edhe në shkrimin tjetër “AK protestë në Korçë – kundër kërkimit të eshtrave greke”, ku citohet një eksponent i AK që thotë se: “...financuesit shqiptarë të Agimit të Artë duhet të arrestohen. Vangjel Dule dhe Spiro Ksera, aktivistë të qarqeve antishqiptare. Koalicioni i tradhtarëve do të marrë ndëshkimin e duhur”¹¹⁸. Akuza të tilla të bëra në ligjërimin politik në rrugë dhe ku përdoren ndjeshmëritë etnike për të përfituar kredite politike, vijnë të plota në shkrime, duke përcjellë tek audienca një atmosferë konflikti dhe urrejtjeje ndëretnike.

Në një rast tjetër lideri i AK provokon edhe ndjeshmëritë fetare në një event politik të partisë së tij, dhe, si edhe në rastin e mësipërm, deklaratat e tij citohen të plota, siç ndodh në shkrimin me titull: “Spahiu inaguron xhaminë që s’u ndërtua kurrë”¹¹⁹.

¹¹⁰ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=6913&cat=1>

¹¹¹ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7217&cat=1>

¹¹² <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7404&cat=1>

¹¹³ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7458&cat=1>

¹¹⁴ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7428&cat=1>

¹¹⁵ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=8121&cat=1>

¹¹⁶ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7644&cat=1>

¹¹⁷ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7359&cat=1>

¹¹⁸ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7058&cat=1>

¹¹⁹ www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7618&cat=1

Gjuha që nxit ndjeshmëritë etnike vjen e cituar jo vetëm nga politikanët por edhe nga personazhe të tjerë publikë apo jo publikë, siç ndodh në shkrimet “Demaçi: Koha të bashkohet kombi i ndarë në 6 shtete”¹²⁰, botuar në datën 23 mars dhe “Protestohet në Shkup – shqiptarët thërrasin “Shqipëri etnike”¹²¹, botuar në datën 8 mars. Thirrje të tilla për rishikim kufijsh apo për “Shqipëri etnike”, konsiderohen si antikushtetuese nga legjislacioni shqiptar. Njerëz që mund të bëjnë kësi deklaratash nuk mungojnë në çdo vend. Por përgjegjësia redaksionale në këtë rast qëndron në faktin se thirrje të tilla konvertohen në lajm që i ofrohet publikut dhe madje vendosen edhe në titull të shkrimeve.

Në disa raste paragjykimet apo stereotipet me baza etnike rrezikojnë edhe objektivitetin e raportimeve për minoritetet në vend. Nga këto raportime kërkohet në mënyrë të veçantë që të shmangen njëanshmëria dhe komentet subjektive të gazetarëve. Por në një rast, në Gazetën Start, reporterit nuk i ka shpëtuar këtij kurthi të raportimit të njëanshëm dhe të komenteve subjektive. Kjo vihet re në shkrimin “Pakicës maqedonase i shtohet “oreksi””, në të cilin gazetari merr përsipër të gjykojë se çfarë i takon dhe çfarë nuk i takon minoriteteve dhe ta konsiderojë një kërkesë të minoritetit maqedonas si “shtim oreksi”. Ja çfarë shkruhet në hyrje të shkrimit:

“Komunitetit maqedonas në juglindje të vendit po i shtohet “oreksi”! Pasi përfituan ndryshimin e emrit të Komunës Liqenas në Pogradec, duke i vënë emër maqedonas Prolec, ata vënë të tjera kushte.

Megjithëse Shqipëria nuk është vend që i diskriminon pakicat, duke i trajtuar si qytetarë të barabartë me të tjerët, minoritetet nga ana tjetër po i shfrytëzojnë këto hapësira, duke kërkuar më shumë të drejta seç ju takojnë”.

Përdorimi i gjuhës përgjithësuese për kombet apo etnitë e tjera, është një tjetër stereotip, reflekset e të cilit shfaqen në 2-3 shkrime të botuara gjatë këtyre dy muajve të monitorimit tek Gazeta Start. Një gjë e tillë ka ndodhur në një shkrim ku perifrashohen komentet e profesorit të Universitetit “John Hopkins” dhe ish-analist i CIA-s, David Kenin, mbi situatën politike në Serbi. Titulli i vendosur nga redaksia për këtë shkrim është: “Serbët, problematikët e rajonit”¹²², ku gjuha përgjithësuese është e evidente. Diçka e ngjashme ka ndodhur edhe në intervistën me titull “Nacionalizmi shqiptar është civil dhe europian, ndryshe nga ai grek dhe serb”. Reflekset e gjuhës përgjithësuese shfaqen edhe në një shkrim tjetër me titull “Çfarë bën një shqiptar kur shefi nuk i jep rrogën”, (në këtë rast gjuha përgjithësuese përdoret për shqiptarët) ku fotografia shoqëruese sjell imazhin e një zgjidhjeje të dhunshme të problemeve, duke nënkuptuar që çdo shqiptar mund ta bënte këtë. Në këtë fotografi paraqitet një makinë e stërmadhe ndërtimi duke shtypur poshtë saj një Mercedes Benz të ri të pronarit që nuk i kishte dhënë rrogën një emigranti shqiptar në Zvicër.

¹²⁰ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=8541&cat=1>

¹²¹ <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=7927&cat=10>

¹²² <http://www.gazetastart.com/index.php?p=hg&hid=6891&cat=10>

❖ Albeu

URL: <http://www.albeu.com/>

Nga tre websitet e monitoruara, sipas motorit statistikor Alexa, Albeu rezulton të jetë më i klikuari, duke u renditur i 18-ti në top-listën e 100 websiteve më të vizituara në Shqipëri¹²³. Kjo rezulton edhe nga të dhënat e [trafficestimate.com](http://www.trafficestimate.com), sipas të cilit numri i vizitave në Albeu për muajt shkurt dhe mars 2013 varion nga rreth 950000 deri në 1050000 në muaj¹²⁴.

I themeluar në korrik të vitit 2003, Albeu ka arritur të krijojë një profil të vetin mes websiteve të tjera të lajmit shqiptar online. Mes të tjerash Albeu dallohet për një raportim të shpejtë dhe të balancuar. Bie në sy në politikën redaksionale përgjegjshmëria dhe vullneti pozitiv për një informim korrekt, profesional dhe përgjithësisht të distancuar nga influencat politike apo influenca të tjera të tërthorta.

Është pikërisht kjo politikë editoriale që ka sjellë rezultatet e veta edhe në shmangien e problemeve etike dhe të gjuhës së papërshtatshme. Kështu, nga monitorimi i kryer gjatë dy muajve, rezultojnë shumë pak raste të pranisë së gjuhës së urrejtjes.

Një kujdes i veçantë i kushtohet në këtë website shmangjes së gjuhës së urrejtjes politike, nga e cila rrezikohen më së shumti mediat shqiptare. Në shkrimet e botuara citohen apo perifrazohen shumë rrallë ato pjesë të ligjërit politik që përmbajnë gjuhë urrejtjeje, fyerje, fjalor të ulët apo sulme personale. Në shumicën e rasteve, nga politikanët janë cituar vetëm ato pjesë të ligjërit të tyre që ngrenë probleme të rëndësishme. Edhe kur ka akuza të ndërsjellta, janë cituar ato akuza apo kritika që janë parimore dhe lidhen me problematikën reale të ushtrimit të pushtetit nga administrata dhe të zgjedhurit, duke shmangur akuzat dhe luftën personale. Politika “prodhon” mjaft scoop-e që kanë ngarkesa negative apo gjuhë të papërshtatshme. Pothuajse të gjitha mediat në Shqipëri janë në gjueti të vazhdueshme të këtyre scoop-eve për të mbushur me to faqet e gazetave apo të websiteve si dhe minutazhin informativ të lajmeve televizive. Albeu në përgjithësi i është shmangur kurthit të scoop-eve politike duke ndjekur një politikë editoriale më racionale dhe më të kujdeshme.

Ndër rastet e pakta ku ndeshet dhunë verbale politike, janë disa shkrime ku raportohet për veprimtari të partisë Aleanca Kuqezi, si psh. në shkrimet: “AK në Lushnje: Të çlirojmë Shqipërinë nga okupatori më i egër i shekullit”¹²⁵, botuar në datën 16.03.2013, “Spahiu në Lezhë: Me 7 prill pa Berishen”¹²⁶, botuar në datën 02.03.2013, “Spahiu: Koalicioni i tradhtarëve në 100 ditët e fundit”¹²⁷ botuar në datën 13.03.2013, dhe “Spahiu: Me 7 prill, të largojmë Berishën nga pushteti,”¹²⁸ botuar në datën 29.03.2013.

Në raportimet për veprimtaritë apo deklaratat e të njëjtës forcë politike ndeshet gjithashtu edhe një lloj gjuhe me ngarkesë nacionaliste, si në shkrimet “Berisha-Samaras, pazar eshtrash në

¹²³ <http://www.alex.com/topsites/countries/AL>, Aksesuar më 14 maj 2013

¹²⁴ <http://www.trafficestimate.com/www.albeu.com>, Aksesuar më 28 shkurt 2013 dhe 31 mars 2013

¹²⁵ <http://www.albeu.com/shqiperi/ak-ne-lushnje-te-clirojme-shqiperine-nga-okupatori-me-i-eger-i-shekul/103462/>

¹²⁶ <http://www.albeu.com/shqiperi/spahiu-ne-lezhe-me-7-prill-pa-berishen/102159/>

¹²⁷ <http://www.albeu.com/shqiperi/spahiu-koalicioni-i-tradhtareve-ne-100-ditet-e-fundit/103171/>

¹²⁸ <http://www.albeu.com/shqiperi/spahiu-me-7-prill-te-largojme-berishen-nga-pushteti/105182/>

pazarin e Korçës”¹²⁹, botuar në datën 14.02.2013, ““Fytyrat e Krimet”, Spahiu padit ministrin Ksera”¹³⁰, botuar në datën 06.02.2013, “Spahiu në Sarandë: Po na grabisin detin, bregun dhe historinë”¹³¹, botuar në datën 10.02.2013, “Spahiu kundër marrëveshjes për zhvarrimin e eshtrave të ushtarëve grekë”¹³², botuar në datën 11.02.2013 dhe “Miqte në Facebook, Spahiu: Berisha, me 100 mijë simpatizantë serbë”¹³³, botuar në datën 09.03.2013. Në të gjitha rastet e mësipërme gjuha e papërshtatshme gjendet në citimet e deklaratave të politikanëve të AK dhe jo në tekstin e gazetareve.

Një lloj qasje delikate ndaj ndjeshmërive fetare përcillet edhe në shkrimet “Ortodoksët në Shqipëri, sa janë dhe sa sulmohen?”, botuar në datën 01.02.2013 dhe “Pas Berishës dhe Ramës, AK “inauguron” Xhaminë e Namazgjasë”, botuar në datë 01.03.2013. Në shkrimin e parë gazetari aludon në titull për një “sulum” ndaj ortodoksëve në Shqipëri, ndërkohë që intervista që vjen e botuar në kuadër të këtij shkrimi, nuk reflekton diçka të tillë. Edhe hyrja e shkrimit përmban një sintaksë fetaro-nacionaliste të pakuptimtë dhe të panevojshme. Ja si fillon shkrimi: “Të jesh ortodoks në një masë të gjerë në shoqërinë shqiptare identifikohet me të qëniti grek.” Në këtë konstatim subjektiv të gazetarit ka, në rastin më të mirë, mosnjohje apo perceptim të gabuar të realitetit. Gjithashtu përkatësia fetare nuk ka lidhje me përkatësinë etnike dhe nuk mund të rrjedhin nga njëra-tjetra.

Me një lloj gjuhe ku nuk mungojnë refleksionet e sentimenteve nacionaliste është raportuar edhe në shkrimet “Protestë në Gjirokastrë: “Epiri është Shqipëri”, botuar në 2 mars dhe “Festa e Kombëtare e Greqisë, KPR: Agimi i Artë të mos tentojnë të hyjë në Shqipëri” botuar në 20 mars”. Në shkrimin e parë teksti i raportimit duket sikur është shkruar nga një prej pjesëmarrësve të protestës:

“Me pankarta në duar “Epiri është Shqipëri” dhe me vargje këngësh patriotike, të rinjtë e shoqatës “Reago”, të mbështetur edhe nga aktivistë të lëvizjeve të tjera patriotike në vend protestuan të shtunën në Gjirokastrë ndaj qëndrimeve fashiste dhe naziskine që vijnë prej qarqeve të caktuara nacionaliste greke. Një flamur gjigand prej 400 metër katrorë, ka ndezur thirrjet patriotike dhe situatën në sheshin para monumentit të Çercizit.”¹³⁴

Lidhur me komentet e lexuesve, Albeu ka aplikuar një politikë bllokimi apo filtrimi skrupuloz. Është kjo arsyeja që numri i komenteve të botuara është shumë i vogël. Në rastet kur komentet janë publikuar, teksti i tyre është korrekt dhe pa prani të gjuhës së papërshtatshme.¹³⁵ Dihet se komentet janë një hapësirë interaktive e rëndësishme për gazetarinë online, pasi përmes tyre

¹²⁹ <http://www.albeu.com/shqiperi/ak-berisha-samaras-pazar-eshttrash-ne-pazarin-e-korces/100458/>

¹³⁰ <http://www.albeu.com/shqiperi/fytyrat-e-krimet-spahiu-padit-kseren-/99588/>

¹³¹ <http://www.albeu.com/shqiperi/spahiu-ne-sarande-po-na-grabisin-detin-bregun-dhe-historine/100005/>

¹³² <http://www.albeu.com/shqiperi/spahiu-kunder-marreveshjes-per-zhvarrimin-e-eshttrave-te-ushtarëve-grek/100122/>

¹³³ <http://www.albeu.com/shqiperi/miqte-ne-facebook-spahiu-berisha-me-100-mije-simpatizante-serbe/102710/>

¹³⁴ <http://www.albeu.com/shqiperi/proteste-ne-gjirokaster-epiri-eshte-shqiperi-/102188/>

¹³⁵ Komete janë ndeshur në shkrimet: “Klani ia kalon “Llafeve të dynjasë””, “Para nisjes së luftës së Kosovës, Berisha kërkoi të burgosë Hashim Thaçin”, “Spahiu në Lezhë: Me 7 prill pa Berishen”, “Miqte në Facebook, Spahiu: Berisha, me 100 mijë simpatizantë serbë”, Pëllumb Xhufi: Peticioni, politik dhe “anti-Turqi”.

tërhiqen mendimi apo opinionimi i lexuesve për problematikën apo informacionin e sjellë në një shkrim. Shumë studiues kanë shprehur mendimin se mungesa apo kufizimi i mundësive për koment nga ana e lexuesve, bën që një pjesë e mirë e audiencës të largohet. Disa website të mediave të njohura në Shqipëri e konsiderojnë komentin si një komponent që shton vizitat dhe numrin e klikimeve në një website, dhe për këtë arsye aplikojnë një politikë të “dyerve të hapura” për të gjitha llojet e komenteve, duke lejuar shkelje të rënda të etikës në to . Por praktika e Albeu provon se edhe duke bllokuar apo filtruar hapësirën e komenteve, mund të jesh në gjendje që të sigurosh një audiencë të konsiderueshme. Në renditjen e websiteve shqiptare të lajmeve, Albeu është i teti dhe ky pozicion dëshmon për audiencën e gjërë të arritur në dhjetë vitet e ekzistencës së tij, edhe pse ka aplikuar këtë politikë të rreptë filtrimi ndaj komenteve.

Përfundime

Duke monitoruar në vazhdimësi hapësirën shqiptare të lajmit online, mund të ravijëzojmë disa karakteristika dhe tipare të përgjithshme që lidhen me problematikën etike, me një fokus të veçantë në përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

Së pari, në një vështrim të përgjithshëm, rastet më të shumta të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, të sulmeve personale dhe të fjalorit të ulët ndeshen në lajmet dhe informacionet që kanë lidhje me zhvillimet politike në vend.

Gjuha e urrejtjes politike përdoret dhe gjendet shumë më dendur se sa gjuha e urrejtjes me bazë etnike, fetare, racore, etj. Madje në një pjesë të mirë të rasteve gjuha me ngarkesë negative etnike, është përdorur në debatin apo ligjërimet politike, duke kaluar në ekstremin ku argumenti etnik thirret në mbështetje të argumentit politik.

Edhe gjatë analizës sasiore që kemi bërë për tre websitet e monitoruara, rastet më të shumta lokalizohen brenda rubrikës apo kategorisë së politikës, dhe më pak në kategori të tjera si “bota”, “rajoni”, dhe akoma më pak në kategori të tilla si “ekonomia”, “kultura”, “sporti”, etj.

Së dyti, rastet më të rënda të dhunimit të etikës dhe të përdorimit të gjuhës së urrejtjes hasen në websitet me audiencë të papërfillshme, periferike, të cilat janë krijuar nga individë që s’kanë lidhje me gazetarinë dhe që janë dukshëm të ndikuar nga stereotipe dhe paragjykime të natyrave të ndryshme, apo nga persona kontraversalë, të papërgjegjshëm dhe që frymëzohen nga qëllime të errëta, si, përhapja e mesazheve fundamentaliste, nxitja e dasive dhe e konfliktit etnik apo fetar, etj. Është fakt i njohur që në shoqërinë shqiptare toleranca ndëretnike dhe ajo ndërfetare kanë qënë dukuri mbizotëruese, ndërsa racizmi dhe fundamentalizmi ekstrem nuk kanë arritur që të kenë ndonjë lloj përhapjeje apo institucionalizimi. Dukuri të tjera shqetësuese si antisemitizmi apo nazizmi gati nuk ekzistojnë ose shfaqen shumë rrallë dhe nuk kanë asnjë lloj mbështetjeje në opinionin publik. Meqënëse shumë nga websitet ku shfaqen rastet më të rënda të dhunimit të etikës dhe të përdorimit të gjuhës së urrejtjes kanë audiencë të papërfillshme, në këtë studim do të shmangim përmendjen e URL-ve së tyre, për të mos iu dhënë asnjë shans publiciteti, por natyrisht do të përmendim problematikën që ndeshet në to, për ta analizuar për efekte studimore.

Së treti, ka një dallim të dukshëm mes përmbajtjes së krijuar nga gazetarët dhe asaj që gjendet në komentet e vizitorëve, kur bëhet fjalë për gjuhën e përdorur në to. Kështu, gjuha e urrejtjes dhe gjuha denigruese, fyerjet dhe sulmet personale janë shumë herë më të theksuara dhe më të pranishme në komentet për shkrimet se sa në vetë shkrimet. Kjo vjen për arsye të mos-filtrimit të komenteve për shkak të mungesës së burimeve njerëzore që mund të angazhoheshin për këtë qëllim, por në ndonjë rast edhe për shkak të politikës editoriale, që lejon qëllimisht komente të rënda që adresohen kundër forcave politike apo personazheve të kampit të kundërt. Një gjë e tillë është evidente sidomos në ato website apo media që anojnë dukshëm nga njëri prej kampeve politike në vend.

Së katërti, nëse marrim në analizë vetë tekstin e shkrimeve, gjuha më e rëndë gjendet tek citimet apo perifrachimet që vijnë nga politika apo nga personazhe kontraversalë të shoqërisë se sa në tekstin e shkruar nga vetë gazetarët. Natyrisht kjo nuk e shmang përgjegjësinë e reporterëve dhe profesionistëve të medias për të qënë më selektivë dhe më të kujdesshëm në citimin apo perifrachimin e ligjëratave që mbartin gjuhë urrejtjeje apo fyerje dhe sulme personale.

Së pesti, ka një lloj dallimi në gjuhën e përdorur edhe mes disa websiteve të gazetave dhe të televizioneve kryesore si dhe portaleve të lajmeve të krijuara nga kompanitë e mediave tradicionale nga njëra anë dhe websiteve individuale më serioze dhe më të njohura, nga ana tjetër. Kështu, përshembull, website, agjensi lajmesh apo portale individuale me audiencë të konsiderueshme si Albeu, Gazeta Start, Noa, etj. janë më të kujdeshme në përdorimin e gjuhës negative dhe sidomos në filtrimin e komenteve që bartin urrejtje dhe paragjykime ekstreme se sa website të mediave të tilla të njohura, si Tema, Shqip, Shqiptarja.com, Balkanweb dhe së fundi edhe gazeta Shekulli dhe Panorama. Një nga shkaqet për këtë mund të jetë edhe fakti që websitet individuale janë më pak të anuara dhe të ndikuara nga politika dhe nga interesat që gjenerohen prej saj. Mbijetesa e tyre nuk sigurohet nga mbështetja politike apo interesa të tërthorta të lidhura me të, siç ndodh rëndom me mediat e mëdha, por kryesisht nga praktika dhe suksesi i biznesit të tyre mediatik.